



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
No. / Br.	34861/25
Nr. i fq. / Br. st.	1
Data / Datum:	21.07.25
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 124/25 21/07/2025

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **31 korrik 2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 korrik 2025;
2. Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për periudhën janar – qershor 2025;
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024;
4. Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2024/2025;
5. Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
6. Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë;
7. Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale 2025-2028;
8. Propozim-vendim për ofrimin e mbështetjes financiare për z.
9. Rishqyrtimi dhe harmonizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës me numër të protokollit Nr.25196/25 i datës 03.06.2025 për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës -ri rregullim të kufirit të pronës në rr. “Ismail Parduzy” në Vushtri sipas gjendjes faktike;
10. Rishqyrtimi dhe harmonizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës me numër të protokollit Nr.25199/25 i datës 03.06.2025 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës -ri rregullim të kufirit të pronës të SHMU Ali Kelmendi në Vushtri sipas gjendjes faktike;
11. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRIN

Nr. / Bt. 34 824/25

Nr. i fq. / Bt. nr. 2

Data / Datum: 21.07.25

VUSHTRRI - VUČITRIN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrin – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 123/25, 21.07.2025

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 21.07.2025

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 21 korrik 2025 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Raport për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për periudhën janar – qershor 2025.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2024/2025.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përgatitet një informatë më e detajuar dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale 2025-2028.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Kërkesë për përkrahje financiare për shërim për Ilir Pllanën.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përkrahet financiarisht me shumën 4500€ dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-99/25 09.06.2025

PROCESVERBAL

**NGA MBLEDHJA E GJASHTË E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, PËR VITIN 2025 MBAJTUR MË: 26 QERSHOR 2025**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:20**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Mek Selaci, Jeton Gjaka, Spasoje Stefanoviç, Refik Maloku, Ramadan Parduzi, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kastrati, Mensur Kasumi, Nurie Halili, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Nasuf Aliu, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Bujar Pllana dhe Gentiana Rama.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 33 anëtarë të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetarja znj. Hava Mlinaku-Rruka, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-pasi hapi mbledhjen konstatoi se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen dhe marrjen e vendimeve të plotfuqishme, deklaroi se për pikat e rendit të ditës materialet i kemi dorëzuar me kohë dhe nuk ka ndonjë pikë shtesë për futje në rend dite.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-parashtroj kërkesën e banorëve të rr.”Hazir Gjaka” ku banorët kërkojnë që në këtë rrugë të vendosen disa pengesa me qëllim të pengimit të zhvillimit të shpejtësisë me automjete. Këto pengesa duhet të bëhen me asfalt dhe të fillojnë nga ura në këtë lagje.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-duke adresuar kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: Të dashur qytetarë të Vushtrrisë, sot nuk flasim fjalë boshe, por për të vërtetën që secili prej nesh e jeton çdo ditë. Sepse pas katër vitesh të kësaj qeverisje, Vushtrria është më shumë se kurrë një qytet pa drejtim, pa zhvillim dhe, fatkeqësisht, pa shpresë. Kryetari aktual, Ferit Idrizi, nuk ka përmbyllur asnjë projekt serioz gjatë mandatit të tij katërvjeçar. Premtimet e bëra janë harruar, ndërsa problemet janë shtuar. Ai premtoi zgjidhjen e problemit të ujit të pijshëm brenda 6 muajve të parë, por edhe pas katër vitesh, shumë lagje dhe fshatra vazhdojnë të jetojnë pa ujë. Rrugët e qytetit janë në gjendje të mjerueshme, asfaltime gjysmake, gropa në çdo cep, dhe mungesë totale e standardit. Komuna është futur në borxhe serioze, si pasojë e kontratave të lidhura pa mbulim financiar. Ndërkohë, punimet në sheshin e qytetit janë kthyer në shembull të keqmenaxhimit. Dhe ç’ është më e rëndë, trashëgimia jonë kulturore është dëmtuar rëndë, si në rastin e Kalasë dhe Urës së Gurit. Kjo është e vërteta që nuk mund të fshihet. Dhe kjo është arsyeja pse Vushtrria ka nevojë për një drejtim të ri, të përgjegjshëm dhe me vizion të qartë.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit- duke adresuar kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: kryetari i komunës është duke provuar që dështimin e tij ta mbulojë me disa arsyetime që janë të paqëndrueshme dhe të pavërteta. Në këtë kontekst shtoj se jemi dëshmitar se qeverisja e Ferit Idrizit, ka dështuar të përfundojë asnjë projekt të vetëm për qytetin e Vushtrrisë. Ky është një fakt që qytetarë e komunës së Vushtrrisë janë ka e prekin për çdo ditë. Arsyetimit e kryetarit të komunës të paqëndrueshme dhe të pavërteta përmes sejmeneve dhe servileve të tij patronazhis, po provojnë të justifikojnë dështimet e tyre në çdo projekt kapital me dëmet nga kontrata kolektive, dhe kjo është krejtësisht i paqëndrueshëm. Nëse kthemi në retrospektiv çfarë kishte deklaruar Ferit Idrizi në fushatë i cili patë thënë asokohe se arsimtaret fare nuk do të kenë nevojë të shkojnë në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre nga kontrata kolektive sepse vetë do të i realizoj ato të drejta përmes listë së pagave. Kjo lere që nuk ka ndodhur por ai nuk e ka fol asnjë fjalë të vetme edhe kur ishte drejtor në Ministrinë e Arsimit për dëmet që janë shkaktuar nga lidhja e kësaj kontrate me dëme katastrofëale financiare për komunat. Fakti tjetër është se nuk mund të kemi arsyetime për dështimin e projekteve kapitale në komunë, sepse nuk është duke u përballur me efektet financiare nga kontrata kolektive vetëm komuna e Vushtrrisë por të gjitha komunat e Republikës së Kosovës apo shumica e tyre, kjo nuk e shfajëson kryetarin e komunës për dështim në realizimin e projekteve vitale për komunën. Për ta dëmtuar kryetarin e komunës se dëmi vjen nga kontrata kolektive deklaroi se në vitin 2022 Komuna e Vushtrrisë ka pësuar një dëm të jashtëzakonshëm financiar duke shkuar në suficit mbi 4 milion euro dhe kjo është një humbje kapitël për zhvillimin e komunës sonë. Edhe njëherë përsërit se tendenca për ta arsyetuar dështimin në zhvillimin e komunës dhe në projektet kapitale, nga kontrata kolektive është një arsyetim i mjerë dhe i pavërtetë. Sikur projektet do të kryheshin me kohë pagesat do të bëheshin për operatorët ekonomik atëherë edhe mjetet nuk do të mund të përmbroheshin, por meqë ke dështuar atëherë përmbaruesi i ka ekzekutuar mjetet për kontrata e mësimdhënësve. Madje madje kryetari aktual i komunës në vitin 2024 e kishte paraqitur si sukses realizimin e buxhetit me paratë që janë shkuar për mbulimin e vendime gjyqësore nga kontrata kolektive, por kjo nuk shitet kryetar sepse nuk kemi të bëjmë me realizim të buxhetit dhe me projekte por me mbulimi të borxheve nga kontratat kolektive për mësimdhënësit dhe punëtorët shëndetësor, të Komunës së Vushtrrisë. Më tej shtroj se përse nuk po përfundohen me kohë projektet kapitale, sepse komuna e ka të drejtën që nëse një operator ekonomik ka vonesa në përmbushjen e kontratës atëherë komuna e ka të drejtën ta shkëpus kontratë me atë operator, por pse nuk po shkëputen këto kontrata edhe pse nuk po përfundohen projektet për këtë ka vetëm një përgjigje, sepse ka keqpërdorim të fondeve publike nga kjo qeverisje.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- Asamblisti i Kuvendit Komunal nga radhët e LDK-së, Ramadan Parduzi, ngriti shqetësime publike lidhur me mungesën e transparencës në procesin e ndarjes së subvencioneve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Vushtrri. Parduzi ka bërë të ditur se më 3 qershor 2025 ka dorëzuar një kërkesë zyrtare për qasje në dokumente publike, përmes së cilës ka kërkuar informacione të detajuara lidhur me listën e organizatave joqeveritare përfituese të subvencioneve për vitin 2025, përfshirë pronësinë, përfaqësuesit ligjorë, vlerën e fondeve dhe arsyetimet për ndarjen e tyre. Sipas tij, përgjigjja e pranuar nga Drejtoria përkatëse ka qenë e përgjithshme dhe jo e plotë, duke mos përmbushur kërkesat ligjore për transparencë dhe qasje në dokumente publike. Ai thekson se një mungesë e tillë e informacionit dëmton procesin e llogaridhënies dhe e pengon mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve publike. “Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e administratës së hapur, kërkoj publikimin e emrave të OJQ-ve përfituese, të përfaqësuesve të tyre ligjorë, vlerën e saktë të subvencioneve si dhe projektet përkatëse,” ka deklaruar Parduzi. Në fund të reagimit të tij, ai ka paralajmëruar se në mungesë të një përgjigjeje të plotë dhe të qartë, do të ndërmarrë hapa ligjorë për të siguruar qasjen në të dhënat që, sipas tij, i takojnë me të drejtë qytetarëve. LDK në Vushtrri ka bërë thirrje të vazhdueshme për më shumë transparencë dhe llogaridhënie në përdorimin e buxhetit komunal. Po ashtu në mungesë të këtyre informatave ai u zotua se do ta ndjek rrugën ligjore për qasje në dokumentet publik ashtu që ky proces të bëhet plotësisht transparent për publikun. Në fund deklaroi se ngritja e flamurit në fshatin Vesekoc është bërë më datën 28.06.1912, ndërsa në vend ngjarje tek guri në atë vend është evidentuar se kjo ngjarje ka ndodhur më 30.06.1912 por kjo është e pasaktë. Po ashtu është bërë edhe ndryshimi i pikës ku është ngritur flamuri në distancë prej 300 metra, kërkojë nga kryetari i komunës që të bëhet përmirësimi i këtyre lëshimeve.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij para kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: është interesant se si po ndërron fjalori i opozitës veç sipas interesit të ditës. Dje na thoshin ku janë punët ku është Ferit Idrizi? pse s’ka zhvillim? Sot, kur krejt po shohin se qyteti po ndryshon e po zhvillohet, tash po dalin me tjetër ankesë: po punohet shumë! Qysh po ju pengon puna? Punët janë nisë prej fillimit të mandatit e tash veç po shihen rezultatet. Sheshi i qytetit – projekt madhor, me standarde moderne, me mbi 100 parkingje nëntokësore Shkolla e re “Mustaf Venhari” po ndërtohet shkollë e re pas shumë viteve tregu i gjelbër vend dinjitoz për qytetar e tregtar, rrugët hyrës në qytet arterie që lidhin qytetin, parku tek xhamia vend i ri projekt i ri në zemër të qytetit do të shërbej për relaksim, me ndriçim, ulëse e gjelbërim dikujt këtu edhe ajo po i pengon! Disa ditë ma herët u bë edhe gjelbërimi aty tek rrugët nëpër lagje që nuk janë prek kurrë për dekada, tash janë me asfalt e ndriçim. Tash po ju pyes kur s’ka pas punë, thoshit ku janë punët tash që punohet pa ndalë, po thoni “po punohet shumë”?! Vendosi një herë a po doni punë a jo? Apo po ju pengon se qytetari po e sheh dallimin mes atyre që vetëm premtuan edhe atyre që po veprojnë. Frika prej suksesit të dikujt tjetër, është thjesht kompleks i atyre që s’kanë vizion. Nuk është faj i Ferit Idrizit që ka projekt pas projekti po është faji i juve që për vite të tëra s’keni lënë asnjë gjurmë në qytet, e tash s’dini kah me u kap. E Vushtrria s’ka kohë me u marrë me ankesa e klithma të opozitës. Qyteti po ndërtohet, po ecë përpara, po zhvillohet. Kush ka sy sheh. Kush ka vesh dëgjon. Kush ka vullnet punon. Tjerët, le të vazhdojnë me u ankuar.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit, vlerësoi se çështja e ujit të pijes, është problematike në zonat e larta të komunës, por nuk mund të thuhet se nuk ujë në Vushtrri dhe në shumicën e lokaliteteve të komunës. Për këto zonat të larta gjeografike është duke u punuar në instalimin e pompave me të cilat do të bartet uji. Nuk është shumë e rëndësishme se kush do të jetë kryetar komune, e rëndësishme është të zgjidhen problemet e qytetarëve. Sheshi i qytetit është një

projekt i bukur sa ai e ka vlerësuar, po ashtu aty ka edhe një parking nëntokësor jashtëzakonisht të bukur, tani ndoshta ai kryhet tash apo ndoshta shiriti prehet më vonë, sikur shumë shkolla të cilave iu është prerë shirit në mandatin e kaluar edhe pse kanë qenë projekte të PDK-së. Lidhur me disnivele të pllakave të sheshit nuk është se ka informata por pllakat dhe sheshi janë definitivisht të bukura. Më tej shtoj dhe vlerësoi se ky shesh dhe parkingu është ndërtuar me fonde vetanake të komunës dhe nuk di që më herët të ketë pasur një projekt kaq të madh me fonde vetanake komunale. Lidhur me subvencionet për OJQ-të, ai potencoi se do të ishte mirë të shikohet ky proces se kush ka përfituar, por jo vetë për këtë mandat por edhe për mandatin e kaluar të merren emrat dhe të verifikohet se kush kanë qenë në komision dhe të dihet se kush ka përfituar dhe dedikimi se kah kanë shkallë ato mjete nga fondet publike.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, deklaroi se gjendemi në ditë e fundit të muajit qershor, ku po mbretërojnë temperatura të larat, e qytetarë po ballafaqohen me mungesë të ujit të pijë, ndonëse kryetari i komunës kishte premtuar se këtë problem do ta zgjidhte brenda gjatë muajit të parë të qeverisjes së tij. Në qytet kemi kaos dhe një numër i madh i rrugëve është prishur me arsyetimin se ato do të ndërtohen, por punimet në këto rrugë ose kanë ngecur shumë ose nuk po zhvillohen fare, kjo po vështirëson lëvizjen e qytetarëve, ndërsa pluhuri i madh që po haset si dhe gropat e thella nëpër ato rrugë janë bërë pjesë e përditshmërisë për qytetarët e komunës sonë, andaj kësaj kjo gjendje është bërë e padurueshme për qytetarët tanë. Ndriçimi publik si në qytet ashtu edhe fshatra në shumicën e rrugëve është jashtë funksionit, në shumicën e rasteve aty ku ngjiten dritat ato janë të kualitetit të dobët dhe të njëjtat prishen brenda dy apo tri ditëve. Shumica e lagjeve nëpër fshatra kanë probleme me ujëra të zeza, sepse nuk kemi investime në rregullimin e kanalizimeve siç është rasti në Stanoc të Epërm ku kanalizimi është prishur qysh në vitin 2023 dhe akoma nuk është ndërmarr asnjë hap për rregullimin e tij. Punimet në shesh janë duke vazhduar dhe bizneseve në atë perimetër iu kanë shkaktuar shumë dëme në të bërit biznes të cila i keni sjellë buzë falimentimit, dhe për këto edhe pse ka pasur premtime se ato do të ndihmohen një gjë e tillë akoma nuk ka ndodhur. Gjendja në arsim nuk është e mirë sepse shumë shkolla kanë përfunduar vitin shkollor 2024-2025 me mungesa të mëdha të mësimdhënësve si në lëndët gjuhë gjermane, fizikë TIK, informatikë dhe lëndë të tjera. Po ashtu si DKA nuk iu keni ofruar asnjë trajnim apo aftësim profesional mësimdhënësve të komunës sonë. Kryetari i Komunës po e përfundon mandatin e tij dhe do të mbahet mend si kryetarë që ka bërë shkarkime dhe ndërrime të drejtorëve të drejtorive dhe shkarkimin e nënkryetarit të komunës pa dhënë asnjë arsyeim para qytetarëve. Nëse e shohim figurën e këtij kuvendi shohim se të gjithë drejtorët që kanë qenë në fillim të mandatit nuk janë tani në përbërje të qeverisë komunale, sepse të gjithë janë të shkarkuar nga detyra dhe për këtë duhet dhënë përgjegjësi para qytetarëve. Mos subvencionimi i fermerëve për qumësht dhe bletarëve janë po ashtu problematikë në veti, sepse nuk i kanë marrë subvencionet për komplet vitin 2024 edhe pse jemi në gjysmën e vitit 2025. Problemi me qenët endacak është një problem në vete dhe është serioz për të gjithë qytetarët. Po ashtu bashkëpunim me këshillat lokal është në nivelin më të ulët, ku kryetarët dhe këshillat asnjëherë nuk janë kompensuar për punën e tyre.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, deklaroi: Jemi në mesin e vitit, dhe sot më shumë se kurrë e kemi të qartë: këtë vit nuk është punuar për qytetarët, dhe jo vetëm këtë vit, por qytetarëve ju kaloi edhe një mandat pa kërkesa të plotësuar. Në çdo projekt që është nisur, ose është ndalur në gjysmë, ose ka dështuar dhe kjo nuk është statistikë, kjo është jeta reale e njerëzve tanë, që për vite të tëra presin, shpresojnë dhe zhgënjehen. Si dëshmi e freskët e këtij dështimi janë edhe takimet publike me qytetarët lidhur me hartimin e draft buxhetit, që këtë vit si duket janë veç një formalitet në dokumente. Dje paradite, në një mbledhje të Komitetit për

Komunitete, pasi e përmendem që jemi në kohën e takimeve publike dhe se takimi në Prelluzhe do mbahet pasdite, Zdravko Zdravković na tha se nuk kishte fare informacion për takimin në Prelluzhë, ndonëse në dokumente figuron si pjese e grupit punues. A mundeni me ma shpjegua këto letra për kë po bëhen, nëse njerëzit realë as nuk janë të ftuar? Dje, të njëjtën dite vetëm pasdite, ne takimin e planifikuar, në Nadakovic, bashkë me banorët të cilët edhe në moshe kishin marrë mundin të jenë pjesëmarrës në gjithë atë vapë, pritëm mbi gjysmë ore për grupin punues. Asnjë nuk erdhi. Unë e di që këtu nuk qëndron faji i anëtarëve të grupeve punuese por problemi është tek keq menaxhimi i qeverisjes! Atë takim u detyrova ta mbaj unë, jo sepse është detyrë, por sepse është ndërgjegje. Dhe çfarë dëgjova? Të njëjtat kërkesa, vit pas viti. Të njëjtat fjalë, të njëjtat kërkesa, e nder to kryesorja; Kërkesa për UJË! A e dini sa familje në fshatin Sfaraqak dhe fshatra tjera ende nuk kanë ujë të pijshëm? Në këtë vapë, në këtë shekull, në këtë qytet që e quajmë tonin? Ju, a mundeni ta përfytyroni jetën pa ujë? Kjo gjendje nuk është krizë e re, është një plagë e vjetër që askush nuk ka dashur ta mjekojë. E përderisa e kemi këtë gjendje të mjerueshme, në anën tjetër kryetari bën reklamë duke ujitur argjinaturat. Banorët kërkuar edhe kanalizim, edhe rregullim të trotuarit që është lënë në gjysmë që nga nëntori dhe sot është bërë rrezik për këmbësorët, disa kërkuar edhe asfaltim të rrugëve d.m.th, Asgjë më shumë, vetëm kushte për të jetuar si njerëz. Si mund të ndodh që në një qytet ku bujqësia është burim jetese për mijëra familje, Drejtoria e Bujqësisë ka qenë vetëm një nga pikat e organogramit. Asnjë program, asnjë subvencion domethënës, asnjë dorë e zgjatur drejt fermerëve që çdo ditë punojnë tokën për të mbijetuar. Kjo qeverisje, bizneseve nevojtare e të sigjerta që i zgjatën dorën për ndihmë komunës për të hapur fabrika prodhuese e vende pune ua pamundësoj zhvillimin duke fshehur pas tyre oligark që me 3 faqe shkrim, pa drejtshkrim, pa projekt, ti marrin komunës tokë në qendër të qytetit! Ky është realiteti ynë: projekte të lëna në gjysmë, procese që bëhen për sy e faqe, drejtori të paefektshme dhe qytetarë të lënë në harresë. Veç një gjë e di, ne nuk mund të vazhdojmë kështu. Qytetarët meritojnë më shumë. Ata nuk kërkojnë luks, kërkojnë vetëm dinjitet dhe kushte themelore për një jetë të ndershme.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, deklaroi: se është e dhimbshme se si po zhvaten taksat e qytetarëve të cilët e ndajnë kafshatën e gojës për ti paguar ato. Dje ishte mediale se si Drejtoria e Prokurimit e cila udhëhiqet nga një njëri i paditur dhe i pashkolluar, bënë shkelje ligjore duke i përshtatur të gjitha specifikat tenderuese për një tender publik të kurdisur, ku mungon vetëm emri i kompanisë kontraktuese, kjo ka ndodhur në një tender në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Fjala është për ish drejtoreshën e Kulturës znj. Shpresa Rama që bashkëpartiakët e shpërblejnë, e personat me aftësi të kufizuara i harrojnë. Në, mbledhjen e Kuvendit, ajo ngriti çështjen e dy konsulentëve që janë marrë në punë nga Komuna e Vushtrrisë. Njëra nga konsulentet, e pranuar për shërbime në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sportit, është ish drejtoreshë nga radhët e PDK-së në mandatin e kaluar. Për këto shërbime, komuna e ka shpërblyer me hiç më pak se 25,200.00 euro. Pyetja ime ishte e drejtpërdrejtë ndaj qeverisjes lokale: Cili ka me qenë kontributi i saj në DKRS, kur dihet që kjo drejtori i ka mbi 30 të punësuar? Cili është borxhi ndaj saj? A duhej t'i ndaheshin 25,200.00 euro për një grusht votash, apo e keni sponsorizuar për t'ju mbështetur gjatë fushatës për zgjedhjet lokale? Për hir të së vërtetës, para disa muajsh komuna ka marrë edhe një konsulent tjetër në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, kontributi i të cilit për këtë drejtori është të lavdërojë qeverisjen komunale në rrjetet sociale, ndërsa shpërblimi për të është 14,000.00 euro. Personi i dytë i kontraktuar nga Komuna e Vushtrrisë është një psikiatër, z.Azem Haliti i angazhuar për të bërë kontrollet e personave me aftësi të kufizuara në Qendrën Rezidenciale në Llumadh. Vlera e kontratës së tij është 5,400 euro për tri vite shërbim. Ajo që është vërtet e dhimbshme, dhe që më ka prekur thellë, është fakti që personat e akomoduar

në këtë qendër, që janë rezidentë dhe pa përkujdesje familjare janë të harruar dhe të anashkaluar ndër vite. Katër vite me radhë, përveç psikiatrit, ata persona nuk janë vizituar as nga një mjek i mjekësisë familjare, as nga ndonjë stomatolog, as nga ndonjë gjinekolog, e as nga ndonjë psikolog. Kjo është dëshmi e qartë që ata persona janë të harruar nga kjo qeverisje. Me dhjetëra herë kam kërkuar që t'ju sigurohet vetëm një mjet transporti për nevojat e rezidentëve, dhe përgjigja ka qenë gjithmonë: "Nuk kemi buxhet", mirëpo për ti shpërblye bashkë partiakët po ka buxhet. Po të investoheshin 25,200.00 euro në Qendrën Rezidenciale në Llumadh, do t'ua përmirësoni kushtet e jetesës personave që janë pa përkujdesje familjari, e që jetojnë në shtëpinë rezidenciale në Llumadh. Këtu, në këtë sistem, duhet të kesh lidhje politike për të përfituar nga zhvatja e buxhetit komunal. Me të vërtetë është e dhimbshme kjo që ka ndodhur dhe në Komunën tonë.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit në adresim para kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrisë deklaroi: shihet se kemi diskutime nga të gjitha subjektet politike për faktin se tani jemi në prag të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale 2025. Tutje i duke ju referuar takimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit, vlerësoi se është tejet shqetësues fakti i pjesëmarrjes shumë të ulët të qytetarëve në këto takime. Ai gjykoj se kjo pjesëmarrjes e ulët ka vetëm një shpjegim sepse të gjitha partitë politike pa përjashtim që kanë qeverisur në Vushtri, nuk iu kanë përmbajtur premtimeve që i kanë bërë për qytetaret. Kjo është kështu sepse qytetarët tanë nuk janë pyetur për kërkesat e tyre për buxhetimin e projekteve për të mirën e përgjithshme. Pastaj shtoj se ndarja e subvencioneve për OJQ-të që është bërë nga ana e komisionit vlerësues, është bërë por fillimisht ato subvencione janë aprovuar në kuvend dhe kanë votuar të gjitha partitë politike dhe tani nuk ka vend për ankesa sepse është vendim i kuvendit. Në fund tha se buxheti nga niveli qendror për komunat ndahet për kokë të banorëve, dhe është mirë anëtarët e kuvendit të qelin sytë kur të votojnë se kah po orientohen ato mjete, lidhur me subvencionet e OJQ-ve propozoi që ky proces të bëhet krejt transparent duke i publikuar të gjithë emrat e OJQ-ve që kanë fituar në tetë vitet e fundit.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-duke ju referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit sqaroi se në vitin 2022 shuma e buxhetit që pretendohet se është shkuar në suficit në vlerë mbi 4 milion euro nuk është i qëndrueshëm sepse buxheti i mbetur nuk do të thotë se ka shkuar në suficit, sepse në suficit shkon vetëm granti qeveritarë. Në suficit shkon vetëm të hyrat nga fondi 10, dhe ministri i financave me vendim ka pretendua që edhe të hyrat vetanake të iu merr komunave. Në vitin 2022 në suficit kishin shkuar mbi 2 milion euro.

Izet Miftari, drejtor i DKRS-së-deklaroi se çështja e ndarjes së subvencioneve në fushën e Kulturës, Rinis dhe Sportit ka qenë shumë transparente, ku lista e përfituesve është publike të cilën e ka hartuar komisioni. Në vazhdim ai para kuvendit lexoi emrat e përfituesve të subvencioneve të ndara nga ana e komisionit: KHF "Samadrexha" 8600€ BESNIK BASHOLLI, KHM "Vushtria" 8500€ ARBEN KARAQA, KHF "Vushtria" 8300€ FADIL MAXHUNI, OJQ FODEM 4000€ ARIANIT MEHMETI, Shoqata e të Shurdhërve Vushtri 1950€ BESIM RRAHMANI, OJQ "Hargja" 950€ BAJRUSH KOSUMI, OJQ "Vallëzo me NE", 2400 € SAIM BIVOLAKU, KV "AS-Vushtria" (M) 1000 € RAMADAN PARDUZI, JQ "Aktiv Plus" 3400 € FEVZI IGRISHTA, Shoqata Sportive Forca-Tifozët 2300 € IRFAN SHTITARICA, KV "AS-Vushtria" (F) 1000 € MARIGONA MORINA PARDUZI, OJQ "EVDS" 3100 € AURORA ZYMBERI, Shkolla e tenisit "Vushtria" 500 € IRFAN HASANI, Shoqata e Peshkatarëve "Sitnica" 2650 RAMADAN RASHANI, Klubi i Basketbollit "Gjimnazisti" 500€ SAFET SHALAKU, GR. Për Drejtësi Zhvillim Demokratik 600 € AJET AVDULLAHU, Klubi i Ping-Pongut Vushtria (M) 2000 € SHPETIM PLLANA, Klubi i Basketbollit Vushtria-Basket 600 € ARIANIT MORINA, Pedagogët e Kulturës dhe Sportit 1000 € VLLAZNIM SHABANI, OJQ "Phoenix" 750 € DIONA

KRASNIQI, JQ "Partart" 2000 € ARBEN ELSHANI, OJQ "SBZHD" 700 € AFRIM TAHIRI, OJQ "Drita Jonë" 1650 € SEVDIE VOCA, Klubi i Gjinnastikës "Vushtrria" 1150 € ARIANIT MORINA, OJQ "L'art Youth Gallery" 8000 € FJOLLA FERATI, OJQ "ORDA" 1050 € RINOR BEQIRI, OJQ "The Power of Mind" 1000 € FATON TERNAVA, Klubi i Volejbollit Vushtrria (F) 2000 € BLERIM KALLUDRA, OJQ "Viciania 2019" 4150 € MIRDON SADIKU, JQ "Çeshme 2" 1000 € BERAT MAXHUNI, OJQ "UP Star" 3850 € QAMIL SAHITI, FC "Forca" Vushtrri 1000 € ENIS TERNAVA, OJQ "Strategjia Rinore" 2000€ BERAT MULAKU, OJQ "Biodiversiteti" 4500 € RAMIZ PARDUZI, Klubi i Basketbollit "Vushtrria" 1000 € XHEVDET ADEMI, OJQ "Sporti pa Kufi" 5200 € GUXIM HAJRA, Klubi i Boksit "Kalaja" 850 € ILMI OSMANI, Klubi i Kik Boksi "Vushtrria" 2800 € LTUFI MENGJIQI, Klubi i Ping-Pongut "Vushtrria" (F) 2000 € PETRIT DRENICA. Lidhur me këto subvencione dhe këta përfituesë kemi pasur vetëm një ankesë ku një përfitues nuk është pajtuar me shumën e mjeteve financiare që ka përfituar. Në fund lidhur me çështjen e shënimit të datës së ngritje së flamurit në Vesekoc, nuk dihet saktësisht data kur ka ndodhur kjo ngjarje, por që pandehet se kjo ngjarje ka ndodhur në fund të muajit qershor 1912 ku cekte se Xhemajl Berisha ia ka dorëzuar flamurin Isa Boletinit i cili e ka ngritur flamurin dhe për këtë flasin referenca shkencore të historiografisë shqiptare.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-lidhur me suficitin buxhetor vlerësoi se drejtori veç i pranoi faktet se ai ka qenë mbi 2 milion euro, ndërsa lidhur me subvencionet dhe shpërndarjen e tyre, ceku se si grup kuvendar gjithëherë do të votojnë sepse janë në pyetje klubet tona sportive dhe rinia jonë Vushtrriase, që ne do ta përkrahim, po ky proces duhet të bëhet transparentë dhe të dihet se kush po përfiton nga këto subvencione. Sa i përket investimeve kapitale me një buxhet prej rreth 7 milion euro për projekte kapitale LDK ka furnizuar 70% të qytetarëve me ujë të pijshëm dhe ky është një sukses i jashtëzakonshëm. Kjo qeveri e tanishme ka tentuar të lidhe kontratë në vlerë 3.4 milion euro për 30% të projektit të mbetur për ujin dhe përse gjithë kjo vlerë financiare, kur me 1.7 milion është shtrirë 70% e rrjetit të ujësjellësit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me suficitin buxhetor, ceku se Drejtori i Financave ka pasur mos përputhje me kryetarin e komunës në deklaratimet e tyre për këtë çështje në emision "Jeta në Komunë", e vërteta është se suficit buxhetor ka qenë mbi 4 milion euro, të cilat kjo qeveri nuk ka qenë e aftë të futë në punë në funksion të zhvillimit ekonomik të komunës. Me fjalë tjera nuk keni mungesë të buxhetit por keni paaftësi të qeverisje dhe shpenzimit të buxhetit në zhvillimin e komunës, dhe kjo çështje është e provuar me dokumente zyrtare. Se kjo qeverisje është krejtësisht e paaftë tregon fakti se në vitin 2022 vetëm në shëndetësi kemi suficit mbi 900,000.00 € dhe kjo është shëndetësia me në kryer Nexhmedin Rashicën dhe kjo duhet thënë publikisht. Në ndërkohë kryetari i komunës del dhe i viziton ordinancat private duke e harruar shëndetësinë publike dhe pyetja është se cili është vizioni i kësaj qeverisje, e keni shkatërruar shëndetësinë në Vushtrri, të cilën ai e kishte lënë në fund të mandati të kompletuar infrastrukturën.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-përsëriti se cili është aktiviteti dhe kontributi i këtyre OJQ-ve përfituesë që kanë përfituar shuma të konsiderueshme të mjeteve financiare, në ndërkohë që vetëm para disa muajsh ato janë themeluar dhe regjistruar në ARBK.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-kërkoj të futet në rendin e ditës një kërkesë e parashtruar për kryetarin dhe kryesuesen për ndihmë financiare për shërim për znj. Selvete Deliu.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-pas i përshëndeti gjithë të pranishmit, njoftoi se kërkesa e znj.Selvete Deliu, për ndihmë financiare për shërim, ka kaluar në komision dhe në zyrën e kryetarit, është shqyrtuar dhe është nënshkruar vendim për këtë ndihmë dhe tani pritet ekzekutimi i pagesës.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” 1 votë “kundër”, aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 03 qershor 2025;
2. Draft-Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028 dhe kalendari kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë;
3. Raporti për legalizim për vitin 2024;
4. Propozim- vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri;
5. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 03 qershor 2025;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-kërkoj të bëhet një korrigjim në faqen 1 të procesverbali, diskutimi i z. Refik Maloku, kur deklarohet për propozimet për këmbimin e pronës, kur ai nuk e ka cekur këtë çështje.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-kërkoj të përfshihet në procesverbal, diskutimi i z. Adnan Lahu, lidhur me propozim-vendimin për mirënjohje për z. Arsim Gërxhaliu.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” 2 vota “abstenim” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 03 qershor 2025 me vërejtjet e parashtruara më lartë.

2. Draft-Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028 dhe kalendari kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028, është një dokument strategjike, dhe në rrethanat e një qeveri me vizion, kjo do të nënkuptonte një dokument që do të tregonte kahet e zhvillimit komunal jo vetëm për vitin 2026 por edhe për vitet pasuese. Por e vërteta është se ne jemi duke e përjetuar një qeverisje pa strategji dhe pa vizion për zhvillim, një qeverisje që punon ad-hoc dhe kjo reflekton edhe në këtë dokument që po e trajtojmë. Kjo është kështu për faktin se në faqen shtatë flitet për synime dhe objektivat strategjike ku janë cekur tri sosh: klimë biznesore e përshtatshme për bizneset ekzistuese dhe tërheqjen e investimeve të jashtme me fokus në prodhim përkrahja e prodhuesve, më tej nën-objektivat apo synimet krijimi i qendrës për Zhvillim ekonomik lokal dhe mekanizmave të organizmit të biznesit. Lidhur me këtë ai vlerësoi se nuk pajtohet me këtë synim strategjik, duke shtruar pyetjen se Komuna e Vushtrrisë ka themeluar Drejtorinë për Investime Kapitale dhe Zhvillim Ekonomik, andaj sa është buxheti vjetor për këtë drejtori që ka paraparë komuna për zhvillimin ekonomik. Kjo për faktin se kur i planifikon synimet strategjike atëherë kjo duhet të ndiqet edhe me planifikim të buxhetit për

realizmin e këtyre synimeve. Pastaj synimi i dytë strategjike është Bujqësi moderne me produktet kualitative industriale dhe të konsumit direkt për tregun lokal. Nënë pikat e këtij synim janë krijimi i oazave Bujqësore (kooperativave bashkëkohore), për këtë pyeti çfarë nënkupton kooperativa bashkëkohore, të shpjegohet për faktin se siç dihet botërisht kooperativizimi i pronave ka qenë një doktrinë dhe koncept i sistemi të kaluar monist tashmë i tejkaluar. Ndërsa partia në pushtet në komunë është ithtar i privatizimit të pronave. Një nënpikë e këtij synim është mundësia të aplikimit të teknikave dhe teknologjive moderne bujqësore. Pyetje çka është duke e penguar komunë në aplikimin e këtyre teknologjive? Kush është duke e penguar këtë proces? Në faqen 14 të këtij dokumenti për vitet 2026,2027, dhe 2028 është planifikuar buxhet në totale prej 1,9000.00 € për ndërtimin e shkollave a mund të dimë cilat janë ato shkolla që do të ndërtohen? Ne tani jemi në një gjendje ku shkollat po mbesin bosh, apo me fare pak nxënës, ndërsa ne planifikojmë buxhet për ndërtimin e shkollave, prandaj kjo duhet analizuar se si duhet vepruar. Në faqen 15 flitet për grantin specifik për shëndetësi primare, ku vetëm në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë paraparë 64.16 milion euro, kjo është e pakuptim për faktin se buxheti total i komunës është afër 30 milion euro. Më tej tek kategoria mallra dhe shërbime janë paraparë 19.57 milion euro, shpenzime komunale 2.03 milion euro, kostoja për vizita dhe shërbim 14.23 milion euro. Me këto shifra del se vetëm për shëndetësi janë paraparë afërsisht 100 milion euro, por shtrohet pyetja se ku janë këto mjete, apo vetëm janë shkrua shifra sa për të plotësuar dëshirat por gjendja në realitet është krejt tjetër fare. Këto shifra dhe parashikime absurde tregojë dhe argumentojnë katërçipërisht se nuk e keni idenë dhe nuk bëhet fare fjalë për strategji për zhvillimin e komunës. Më tej flitet për politikat e reja të aprovuara për vitin 2026 ku ceken: intervenim në fëmijërinë e hershme në shumën prej 1.74 milion euro dhe staf shtesë prej 192 nga të cilët Logoped 48, Psikolog 48, Fizioterapeut 48 dhe Punëtor Social 48. Prandaj pyeti se me cilën normativë ligjore keni të drejt të angazhoni këtë staf, kur dihet se këto shërbime i takon kujdesit sekondar shëndetësor që i takojnë nivelit qendror të pushtetit. Kjo tregon se keni mungesë elementare dhe bazike të njohurive të sistemit shëndetësor. Në faqen 33 flitet prapë për shëndetësinë dhe mirëqenën sociale, ku tek indikatorët ceket renovimi i objekteve shëndetësore dhe zbatimi i planit tre vjeçar për përmirësimin e objekteve shëndetësore ku thuhet se për vitet 2022, 2023 dhe 2024 realizimi është në masën 100%, por shtrohet pyetja se si shkuan në suficit më tepër se 900,000 € nga investimet kapitale në fushën e shëndetësisë, dhe në ane tjetër deklaroni se i keni rinovuar 100% objektet shëndetësore. Në fund tha se ky dokument është krejtësisht i pakuptimtë, jo logjik dhe i pambështetur në planifikimet buxhetore. Prandaj është mëkat që qytetare të kenë një qeverisje të tillë sepse ata meritojnë më mirë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028, është dashur të jetë një dokument i cili do të shërbente si një strategji afatmesme për zhvillimin ekonomik të komunës. Duke mos dashur fare të lëshohemi në përmbajtjen e kësaj kornize, ai ri potencoi se komuna aktualisht ka të lidhur dhjetëra kontrata pa mbulushmëri financiare dhe për të cilat as që e ka idenë se kah do ti merr mjetet financiare për përmbushjen e tyre. Pra deri sa po flasim komunën e kemi në borxh enormë, ndërsa tani po miratojmë një strategji, vetëm sa për ti thënë, sepse ne tani i kemi kontratat e për të cilat as që e dimë se ku do ti marrim mjetet dhe kjo kornizë dhe aprovimi i saj është kot.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-duke ju referuar faqes 31 të Draft-Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028, vlerësoi se është shqetësuese se si ky dokument është bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 ku ceket se numri i përgjithshëm është 64,870 banorë, ndërsa popullsia është regjistruar në vitin 2024 dhe numri i përgjithshëm është 61,528, dhe për më keqe është planifikuar që në vitin 2026 komuna e Vushtrisë të ketë 72,762 banorë, pra

gabim në shifrën e banorëve është në proporcionin afër 10,000 banor 9% më shumë në numrin e përgjithshëm të banorëve. Kjo pastaj e dëmton buxhetin e komunës dhe shpërndarjen e tij nëpër kode dhe nën-kode buxhetore. Duke marr për bazë një gabim kaq të rënd, kërkoj që kjo pikë të shtyhet për ndonjëherë nga seanca e ardhshme të kuvendit.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-duke ju referuar, diskutimit të shefit të grupit kuvendar të LVV-së z. Sylejman Mehulli, ceku se duke pasur për bazë raportin vlerësoi se janë të pa qarta tri synime strategjike të komunës së Vushtrisë. Në faqen 4 përmenden tri prioritet e qeverisë komunale për periudhën buxhetor 2026-2028 ku ceken: zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, zhvillimi i barabartë njerëzor, dhe siguria dhe sundimi i ligjit dhe pyeti se çfarë është punuar deri me sot për këto pika. Më tej shtoi se në faqe nr.5 flitet për gjendjen aktuale në ekonom, më pas flitet për burimet natyrore ndërsa pastaj për vizionin e komunës, që është një strukturim totalishtë i pakuptimtë që nuk i posedon premiset e një dokumenti strategjik. Po në faqen 5 ceken se Vushtria ka gjithsejtë 4172 biznese por për të cilat nuk kemi fakte dhe të dhëna se ato a janë aktiv apo jo, më tej nuk flitet për gjendjen e tyre, cili është numri i të punësuarve. Në faqe 7 ceken synimet strategjike dhe shtoi se çfarë është bërë për përmbushjen e këtyre synimeve. Ai pyeti se a di dikush nga anëtarët e qeverisë komunale të bëj dallimin mes objektivave, prioriteteve dhe synimeve strategjike ekonomike. Në faqen 8 në shtylla kryesore flitet për gjendjen sociale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore por askund nuk flitet për arsimin dhe nuk kemi një plan për rregullimin dhe përmirësimin e kësaj fushe. Në faqe 11 është paraqitur një tabelë ku shprehet një trend i rritjes së numrit të bizneseve prej 11,900 bizneseve ndërsa e vërteta është se ne kemi rreth 1200 biznese pra kemi të bëjmë me një pasaktësi elementare. Më tej në faqe 22 janë parashtruar shpenzimet komunale të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe për vitin 2025, për këtë pyeti a ka Drejtori të Ekonomisë apo nuk ka, a është mbështetur kjo drejtori me buxhet apo jo, a k projekt kapitale zhvillimore apo nuk ka, dhe përpos kësaj a kemi Drejtori për Diasporë apo nuk kemi, dhe ajo drejtoreshë që është emëruar a merr rrogë nga buxheti i komunës apo jo cila është përgjigjja e qeverisë komunale. Në fund duke ju referuar faqes 29 të kësaj kornize buxhetor ku janë cekur aty prioritet strategjike thuhet ndër të tjera se si prioritete qeverisëse është shëndetësia dhe infrastruktura komunale, duke u harruar fusha tjera të rëndësishme si arsimi, ekonomi, turizmi kultura e të ngjashme. Kjo e bënë këtë qeverisje komunale, tërësisht jo kredibile, pa vizion e cila po e dëmton zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrisë.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-deklaroi se korniza Afatmesme buxhetore (KAB) për vitet 2026-2028, është hartuar në formën e vetë standarde dhe në mënyrë tejet profesionale, por që fatkeqësisht disa nga anëtarët e këtij kuvendi këtë kornizë janë duke e lexuar së prapthi, dhe po ashtu duke lexuar nga dy apo tre paragraf të saj dhe kështu duke tentuar të thonë diçka sa për të thënë, por që asgjë në realitet nuk është ashtu siç po deklarohet nga ana e tyre. ai shprehu se i vjen shumë keq veçanërisht sidomos prej profesionistëve të fushës së ekonomisë, të cilët të rrëmbyer nga petku politikë që dëshirojnë të duke si njerëz të devotshëm të partive të tyre bien në këtë nivel të jo profesionalizimit. Draft-korniza buxhetore në mënyrë të qarët dëfton se ajo është një dokument që fletë për planifikimin e buxhetit të komunës për vitet 2026-2028. Më tej ai shtoi se me qarkore buxhetore të lëshuar nga MFPT-ja buxheti i komunës nuk ndahet sipas drejtorive por sipas kategorive ekonomike që janë kategori ligjore të alokuara sipas numrit të banorëve nga granit i përgjithshëm dhe nga granit specifik i arsimit dhe ai i shëndetësisë. Tutje shpjegoi në mënyrë të hollësishme se mjetet e parapara për vitet 2027 dhe 2028 janë parashikuese sepse nuk dihet me saktësi se si do të ndryshoj gjendje e zhvillimeve të komunës në aspektin e buxhetit dhe realizmit të tij.

Në fund të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 15 vota “për”, 16 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” nuk e aprovoj Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetor (KAB) për vitet 2026-2028 të Komunës së Vushtrrisë.

3. Raporti për legalizim për vitin 2024;

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se koj informatë është plotësuar pak pas rekomandimeve të bëra nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa. Në këtë kontekst shtoj se Drejtoria e Urbanizimit ka ekzistuar edhe para vitit 2022 ku nuk janë përfshirë disa informata të rëndësishme për këtë periudhë për legalizimin e objekteve në Vushtri. Ajo çfarë është e rëndësishme është fakti se kuvendi duhet të dije se sa kërkesa janë parashtruar nga fillimi i procesit të legalizimit sa prej tyre janë aprovuar dhe sa janë refuzuar.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se është për keqardhje se kush e qeverisë komunën e Vushtrrisë. Mandej ceku se ky dokument-raport nuk i plotëson kriteret elementare të një dokumenti. Në njërin nga paragrafët e tij thuhet se nuk kemi mundur të shqyrtojmë të gjitha kërkesat e parashtruar si rezultat i mungesës së stafit të pamjaftueshëm, dhe kjo është një absurd i llojit të vetë, sepse nuk ka kurrfarë logjike. Lidhur me përmbajtjen e këtij raporti vlerësoi se para disa viteve ish përfaqësuesi i partisë në pushtet aktualisht z.Ilmi Azemi, kishte kërkuar nga DUMM-ja një raport pak më special për lejet ndërtimore sa ka pasur kërkesa, sa janë aprovuar dhe koha për sa janë aprovuar, andaj sot këto informata nuk i kemi dhe do të ishte mirë që këto të bëhen transparente. Ajo çfarë është e rëndësishme është informata se kur ka filluar legalizimi kur është kërkuar ai legalizim kur ka filluar ndërtimi i objekti dhe pronarët e tyre këto janë tema me interes për opinionin publik.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se edhe në Drejtorinë e Urbanizimit mund të angazhohet staf plotësues për shqyrtimin e kërkesave për legalizim të objekteve sikurse ka ndodhur në Drejtorinë e Kulturës ku është angazhuar znj. Shpresa Rama.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 13 vota “për” 9 vota “kundër”, 3 vota “abstenim” aprovoj Raportin për legalizim e objekteve pa leje për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.

4. Propozim- vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri;

Në vazhdim kuvendit me vota unanime aprovoj formimin e komisionit kuvendar për mbarëvajtjen e procesit të votimit të fshehtë për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri në përbërjen si në vijim:

Mentor Ferizi, PDK;
Edona Gashi, LDK dhe
Ymer Haradinaj, LVV;

Pas përfundimit të procesit të votimit të fshehtë kuvendit me 29 vota “për”, 1 votë “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për

ndërtimin e lapidarit për dëshmorin **Bastri-Hajzer Beqiri**, në sipërfaqe prej 100 m², pjesë nga parcela P-70202047-00576-0, nga sipërfaqja e përgjithshme 2100m² pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa me shkrim, lista poseduese e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATA/DATUM/DATE	11.07.2025
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politik dhe Financa-Kuvendin Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
Nga/OD/FROM	Isuf Jashari, Drejtor i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2025

Të nderuar,

Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2025 Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa ju prezanton Raportin e shpenzimeve Janar-Qershor 2025, duke u bazuar në planifikimin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parasë publike për vitin 2025, sipas drejtorive të Komunës së Vushtrrisë.

Shtojcë:

Raportet fizike

Emri i Komunës :		K.K.VUSHTRRI							
Kodi i Komunës:		644							
Periudha raportuese		Janar - Qershor 2025							
TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK									
Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese			Vjetore				Viti i kaluar
		Buxheti i planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhet të realizuar për PR	Buxheti i planifikuar për 2025	Buxheti i mbetur për 2025	Plani i reviduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2024
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11
Administrata dhe personeli	163								
		€	€	%	€	€	€	€	
Taksa administrative		60,000.00	23,149.00	39%	120,000.00	96,851.00	0.00	120,000.00	17,474.00
TOTAL		60,000.00	23,149.00	39%	120,000.00	96,851.00	0.00	120,000.00	17,474.00
Inspeksioni	166								
		€	€	%	€	€	€	€	€
Pranime teknike		4,000.00	7,535.00	188%	8,000.00	465.00	0.00	8,000.00	6,745.00
				0%		0.00	0.00	0.00	
Gjodat e inspeksionit		3,000.00	4,155.00	139%	6,000.00	1,845.00	0.00	6,000.00	2,900.00
TOTAL		7,000.00	11,690.00	167%	14,000.00	2,310.00	0.00	14,000.00	9,645.00
Buxhet dhe Financa	175								
		€	€	%	€	€	€	€	€
Taksat e firmave		7,500.00		0%	15,000.00	15,000.00	0.00	15,000.00	18,000.00
Tatimi në pronë		609,213.50	545,550.00	90%	1,218,427.00	672,877.00	0.00	1,218,427.00	370,249.01
TOTAL		616,713.50	545,550.00	88%	1,233,427.00	687,877.00	0.00	1,233,427.00	388,249.01
Arsimi	900								
		€	€	%	€	€	€	€	€
Shitja e prodhimeve									
Participimi në çerdhen		35,000.00	78,853.00	225%	70,000.00	-8,853.00	0.00	70,000.00	62,724.00
Shkolla e Mesme Teknike		10,000.00	26,082.00	261%	20,000.00	-6,082.00	0.00	20,000.00	16,630.00
Shkolla e Mesme Profesionale		10,000.00	12,080.00	121%	20,000.00	7,920.00	0.00	20,000.00	10,515.00
TOTAL		55,000.00	117,015.00	213%	110,000.00	-7,015.00	0.00	110,000.00	89,869.00
Gjeodezi dhe Kadastër	650								
		€	€	%	€	€	€	€	€
at nga Gjeodezia dhe Kadastër		50,000.00	37,600.80	75%	100,000.00	62,399.20	0.00	100,000.00	47,116.00
Qiraja nga objektet publike		26,500.00	15,410.00	58%	53,000.00	37,590.00	0.00	53,000.00	14,011.60
TOTAL		76,500.00	53,010.80	69%	153,000.00	99,989.20	0.00	153,000.00	61,127.60
Kulturë, rinie dhe sport	850								
		€	€	%	€	€	€	€	€
Palestra e sportit		250.00	325.00	130%	500.00	175.00	0.00	500.00	144.00
Biblioteka		250.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	
Shtëpia e Kulturës		250.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	
TOTAL		750.00	325.00	43%	1,500.00	1,175.00	0.00	1,500.00	144.00
Shërbime publike	180								
		€	€	%	€	€	€	€	€

[illegible]

Emri i Komunës:

Kodi i Komunës:

Periudha raportuese

Shpenzimet Mallra dhe Shërbime dhe Subvencione

KODI	PËRSHKRIMI	Janar - Qershor 2024	Janar - Qershor 2025
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	4,269.30	
13131	Para xhepi/ medijtjet për udhëtime zyrtare brenda vendit	120.00	64.00
13132	Akomodimi i udhëtimit zyrtar brenda vendit		
13133	Shpenzimet e tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit		
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	3,992.75	1,590.00
13141	Meditja e udhëtimit zyrtar jasht vendit	7,854.40	3,221.76
13142	Akomodimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	3,513.55	2,651.14
13143	Shpenzimet tjera e udhëtimit zyrtar jasht vendit	298.50	7,908.10
13310	Shpenzimet për internet	2,056.97	2,628.89
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	11,123.90	16,081.68
13330	Shpenzimet postare	571.20	314.00
13410	Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit	1,000.00	41,019.80
13420	Shpenzimet e përfaqësimit avokaturw	14,848.34	12,423.19
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	3,992.41	5,989.94
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	4,497.50	7,756.45
13450	Shërbime shtypje jo marketing		
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	1,817,660.74	3,111,227.91
13470	Shërbime teknike	11,245.23	16,016.08
13480	Shpenzimet për antarsim	12,240.25	25,240.25
13501	Mobilje (mëpak se 1000 euro)	2,860.00	19,145.50
13502	Telefonat	990.00	
13503	Kompjuterët		2,527.00
13504	Pajisje tjera të teknologjisë		8,410.00
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	18,776.16	73,548.24
13610	Furnizime për zyrë	35,874.82	46,059.80
13611	Furnizim me dokumenta blanko		3,061.90
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	31,033.17	31,321.06
13630	Furnizime mjekësore	31,599.73	31,062.58
13640	Furnizime pastrimi	19,936.90	22,835.06
13650	Furnizim me veshmbathje		
13655	Furnizim me preparate kimike		1,596.50
13710	Vaj		9,450.00
13720	Naftë per ngrohje qendrore	930.90	
13760	Dru	115,699.00	207,726.36
13770	Derivate per gjenerator		
13780	Karburant per vetura	23,042.17	23,195.62
13790	Gas natyror	60.00	
13810	Avanc për para të imëta	3,760.00	2,800.00
13820	Avanc për udhëtime zyrtare	2,931.28	6,612.03
13918	Provizion bankare	2,276.00	8,849.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	495.00	3,973.34
13951	Sigurimi i automjeteve	929.52	1,211.95
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	30.00	630.00
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	24,484.97	23,150.78
14020	Mirembajtja e ndërtesave	912.48	
14023	Mirembajtja e shkollave	2,094.25	43,135.00
14024	Mirembajtja e objekteve shëndetësore	99.00	15,352.00

14032	Mirmbajtja e auto rrugëve lokale	254,982.21	436,473.85
14040	Mirmbajtja e teknologjisë informative		
14050	Mirmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	33,211.49	38,498.00
14060	Mirmbajtja rutinore	26,475.61	
14110	Qiraja për ndërtesa	900.00	750.00
14130	Qiraja - pajisjet	7,771.83	4,848.12
14140	Qiraja makineria	660.00	19,070.40
14210	Reklamata dhe konkurset		1,135.00
14220	Botimet e publikimeve	1,490.00	
14230	Shpenzimet për informim publik	3,440.00	4,506.00
14310	Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	23,306.43	21,839.55
14320	Kompensimi i përfaqësimit jashtë vendit		540.00
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	29,951.81	425,382.99
14510	Pagesa e tatimit në qira		
14415	Pagesa për tarifat vendime gjyqësore - përmbartimore		16,662.50
13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME		2,600,289.77	4,808,692.12

14			
13210	Rryma	210,046.02	211,223.56
13220	Uji	27,046.06	28,274.02
13230	Mbeturinat	11,571.55	17,570.00
13250	Shpenzimet telefonike	3,187.35	5,240.63
13260	Pagesa-vendime gjyqësore		24,600.00
HPENZIMEVE KOMUNALE		251,850.98	286,908.21

20	SUBVENCIONET		
21110	SUBVENCIONET PËR ENTITETET PUBLIKE	147,827.42	85,174.86
21200	SUBVENCIONET PËR ENTITETET JOPUBLIKE	392,052.60	272,683.29
22110	TRANSFERET PËR ENTITETET PUBLIKE		29,450.00
22202	TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË		414,370.00
22298	PAGESAT PËR SHËRBIMET E VARRIMIT		51,600.00
22299	QIRAJA PËR RASTET SOCIALE		600.00
22300	VENDIMET GJYQËSORE		377,691.00
23220	MENAXHIMI I BURIMIT TË UJITJES PËR BUJQËSI		42,594.74
21200	TRANSFERE PËR PËRFITUES INDIVIDUAL	47,894.85	
20 TOTALI I SUBVENCIONEVE		587,774.87	1,274,163.89

Përshkrimi	BUXHETI I PLANIFIKUAR	SHPENZIMI	SHUMA E MBETUR	Përqindja e realizimit
RESP / SUBCL / PCLASS / PROJ	A	C	D	A - (C + D)
644 VUSHTRI	5,977,402.24	4,014,338.18	1,963,064.06	67.16
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,977,402.24	4,014,338.18	1,963,064.06	67.16
16324 ADMINISTRATA - VUSHTRI	5,000.00	4,000.00	1,000.00	80.00
56234 Rehabilitimi i kulmit të komunës	5,000.00	4,000.00	1,000.00	80.00
17524 BUXHETI - VUSHTRI	332.00	0.00	332.00	0.00
60406 ASFALTIMI I RRUGES PANTIN-ASHLAN	331.00	0.00	331.00	0.00
60413 RIPARIM SHF KRASHIQ.POSHTME	1.00	0.00	1.00	0.00
18024 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - VUSHTRI	1,246.59	0.00	1,246.59	0.00
71935 RREGULLIMI I SHESHIT HSAN PRISHTINA	37.00	0.00	37.00	0.00
72228 RREGU.RRUGES BAHRI KUQI SEG 1	375.52	0.00	375.52	0.00
83124 FOND.BASHKFIN.SHTR.RR.KUBEZA	2.00	0.00	2.00	0.00
86140 FONDI JBASHKFINANCIMIT SHTRURJA E RRUGVE ME KUBE	728.07	0.00	728.07	0.00
93129 PTX PER RR.NE L.BUN.SOP.F.SAMA	104.00	0.00	104.00	0.00
18184 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - VUSHTRI	1,271,459.58	829,308.31	442,151.27	65.22
48536 NDËRTIMI I URES NË DOBËRLLUKË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
53182 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË PESTOVË	20,000.00	7,406.79	12,593.21	37.03
53193 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË GOJBULË	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
53220 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË STANOC TË EPËRM -STANOC TË POSHTËM	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
53226 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË MIHALIQ	31,000.00	20,000.00	11,000.00	64.52
53231 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË AKRASHTICË - BALINCË	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
53259 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË PANITINË-OSHLAN	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
53463 NDËRTIMI I PIKAVE PRITËSE NË VUSHTRI	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
53603 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË KOLLË	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
54898 NDËRTIMI E RRUGËVE ME KUBËZA BETONI AGIM ISLAMI ,NEBIH AVDIU	115,000.00	115,000.00	0.00	100.00
54905 NDËRTIMI I RR."BAHRI KUÇI", "MIFTAR SHAQIRI", "47 SHKURTI",	97,282.00	97,282.00	0.00	100.00
54911 NDËRTIMI E RRUGËVE ME KUBËZA GURI KALLDERM PANDELI SOTIRI,SH	122,000.00	74,222.94	47,777.06	60.84
54920 NDËRTIMI I URES NE FSH LUMMADH-VUSHTRI	9,000.00	0.00	9,000.00	0.00
54942 RËGULLIMI I LUMIT TERSTENA-SILNICA VAZHODIM	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
54946 NDËRTIMI I STACIONIT TË POMPIMIT, RRJETIT PRIMAR REZERVUARËV	500,000.00	496,323.48	3,676.52	99.26

55564 Ndërtimi i urës në Akrahticë	9,000.00	0.00	9,000.00	0.00
56322 Ndërtimi i kanalizimit në Druar	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
56325 Ndërtimi i kanalizimit në Banjaskë	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
56330 Ndërtimi i kanalizimit në Shallc	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
56340 Ndërtimi urës në Miraqë me mure mbrojtëse	12,000.00	0.00	12,000.00	0.00
56358 Ndërtimi i vigut në Novolan dhe shetitores	40,000.00	19,073.10	20,926.90	47.68
56359 Ndërtimi urës në Karaqë	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
56360 Ndërtimi i shtëpisë për komunitetin -Oshlam	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
56361 Ndërtimi i parkut rekreativ tek banesat e bardha dhe banesa	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	3,985.65	0.00	3,985.65	0.00
92111 PERFORMANCA KOMUNALE 2021	6,285.73	0.00	6,285.73	0.00
93195 NDERT.PIK.PRIESES PER AUTOB.PRI-ZHI-BIV-STR	906.20	0.00	906.20	0.00
47024 BUJQËSIA - VUSHTRI	1,416,323.00	1,048,906.88	367,416.12	74.06
48182 NGRITJA E PEMISHTEVE.	991.00	0.00	991.00	0.00
49561 PROJEKTE" NË BASHKEFINANCIM ME DONATORE	1,120,998.00	929,370.64	191,627.36	82.91
52290 RREGULLIMI DHE PASTRIMI I LUMIT LLAP-SILNICA	174,332.00	119,536.24	54,795.76	68.57
56362 Rregullimi dhe pastrimi i lumit "Silnica" Vushtri-Smirkoni	120,000.00	0.00	120,000.00	0.00
81152 NGRITJA E SERAVE	2.00	0.00	2.00	0.00
66425 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - VUSHTRI	2,031,620.00	1,202,173.95	829,346.05	59.18
53207 NDËRTIMI I RRUG. "BEKIMI BERISHIA ABEJA"	128,960.00	75,000.00	53,960.00	58.16
53262 NDËRTIMI I RRUG. "AVNI SARAÇI" VICIANA	74,772.00	73,570.86	1,201.14	98.39
53274 RREGULLIMI I RR. "ISAK HALILI" ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLESE	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00
53276 NDËRTIMI I RRUG. "LUMNI SURDULLI"	60,000.00	56,132.59	3,867.41	93.55
53344 RIKONSTUIMI I BULEVARDIT „ADEMI JASHARI" DHE LIDHJA ME	1,120,111.00	694,872.68	425,238.32	62.04
53586 ASFALTIMI I RR. PASOMË	32,000.00	19,578.28	12,421.72	61.18
54750 REHABILITIMI I RRGËVE NË VËRRNICË-SHALLC, AKRASHTICË, BUKOS	25,000.00	20,000.00	5,000.00	80.00
54775 REHABILITIMI I RRGËVE NË BIVOLAK, ZHILIVODË, STROC	25,000.00	5,000.00	20,000.00	20.00
54798 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NE DUNNICE, MAXHUNAJ. STANOC . LUM	25,000.00	5,000.00	20,000.00	20.00
54799 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË GRACË, PRELLUZHË	50,000.00	20,000.00	30,000.00	40.00
54801 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË STUDIME E ULËT, CECELI, SAMADRE	10,000.00	5,000.00	5,000.00	50.00
54808 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË BAJNSKË, PASOMË, SLLATINË, BEGA	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00

54812 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË SHITITARICË, PANTINË, HERCEGOVË,	20,677.00	10,600.00	10,077.00	51.26
54814 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË ĐUKOSH, DOLAK, NOVOLAN	10,000.00	3,000.00	7,000.00	30.00
54819 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË DRUAR, MIHALIQ, REZNIK, SHALLC	10,000.00	3,000.00	7,000.00	30.00
54820 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË STROC, BEQUK, GLAVOTIN, BIVOL	10,000.00	2,262.45	7,737.55	22.62
54834 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË BEÇIQ, ĐUBOC	10,000.00	5,000.00	5,000.00	50.00
54843 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË SKOQNE	10,000.00	5,000.00	5,000.00	50.00
55009 NDËRTIMI I RRUG."2 MAJI" ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLËSE	170,000.00	139,157.09	30,842.91	81.86
56296 Ndërtimi i rrugës Sfarapëk të varrezat	90,000.00	30,000.00	60,000.00	33.33
56305 Ndërtimi i rrugës Vesekoc - Sllakoc segmenti 3	50,000.00	30,000.00	20,000.00	60.00
74460 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - VUSHTRRI	243,858.00	202,883.83	40,974.17	83.20
52719 BLERJA E PAJISJEVE MJEKËSORE QKMF VUSHTRRI	70,000.00	69,883.83	116.17	99.83
56309 Ndërtimi i radiologjisë QKMF Vushtri	138,858.00	119,000.00	19,858.00	85.70
56313 Blerja e pajisjeve, INV-Objekte Shendetesore-Vushtri.	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
56320 Blerja e klimave inverter per QKMF ne Vushtri	15,000.00	14,000.00	1,000.00	93.33
56440 Blerja e pajisjeve QKMF dhe AMF-Vushtri	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
75617 SHËRBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRRI	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
53625 BLERJA E VETURËS PËR SHËRBIMET REZIDENCIALE	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
85024 SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRRI	268,671.02	191,601.26	77,069.76	71.31
51007 RENOVIMI I PALESTRËS „JETON TERRSTENA“	20,530.00	20,530.00	0.00	100.00
51851 Ndërtimi i pllakave përkultimore në Pasomë	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
52825 RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I OBJEKTIT "ARKIVI I VJETËR" JSH F	94,141.00	69,965.23	24,175.77	74.32
54727 RREGULLIMI I MEMORIALVE NË GLAVOTIN, REZNIK, BEÇIQ, ĐUBOC,	79,000.00	71,106.03	7,893.97	90.01
54735 NDËRTIMI/RIKONSTRUIMI I FUSHAVE SPORTIVE MAXHUNAJ, LUMMADH,	50,000.00	30,000.00	20,000.00	60.00
92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	0.02	0.00	0.02	0.00
92670 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET - VUSHTRRI	80,000.00	39,000.00	41,000.00	48.75
56334 Ndërtimi i çerdhës në SHFMU "Enver Hadri" Smrekoniçë	40,000.00	22,000.00	18,000.00	55.00
56337 Ndërtimi i çerdhës në SHFMU "7 Mars" Đukosh	40,000.00	17,000.00	23,000.00	42.50
93690 ARSIMI FILLOR - VUSHTRRI	621,258.00	496,463.95	124,794.05	79.91
53024 NDËRTIMI I SHFMU "MUSTAFA VENHARI "	538,258.00	437,503.95	100,754.05	81.28
56340 Blerja e tabelave të mençura inv. A.Z.Çajupi Vushtri	25,000.00	22,605.00	2,395.00	90.42
56346 Blerja e tabelave të mençur,inv Mustafe Venharin Vushtri	30,000.00	27,492.00	2,508.00	91.64

56351 Tabela SMART për SHMU-1 dhe SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtri	28,000.00	8,863.00	19,137.00	31.65
94890 ARSIMI I MESËM - VUSHTRRI	22,734.05	0.00	22,734.05	0.00
56353 Tabela SMART për gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtri	22,000.00	0.00	22,000.00	0.00
93222 RREGULLIMI I SHKOLLËS BAHRI HAXHA	577.05	0.00	577.05	0.00
95104 FURNIZ.MJETE PER PUNTOR,SALDATOR- AXHUSTATOREVE	157.00	0.00	157.00	0.00
Totali i përgjithshëm	5,977,402.24	4,014,338.18	1,963,064.06	67.16

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategoris ekonomike në investime kapitale është si vijon:

Buxheti i planifikuar në investime kapitale për vitin 2025 është 5,977,402.24euro ,realizimi është 4,014,338.18euro,apo 67.16% realizimi ,shuma e mbetur për gjashtmuorin e dytë në vlerë 1,963,064.06euro, është në procedure e sipërme të realizimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë (VU), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 774,368€;
- B2 Blerje të pasurisë jo kapitale në vlerë 651,807€ nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe sistemin e e-pasurisë, duke shkaktuar nënvlerësim të pasurisë në raportin vjetor financiar për këtë shumë;
- B3 Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin vjetor financiar ishin mbivlerësuar për 129,431€;
- B4 Obligimet e papaguara të shpalosura në raportin vjetor financiar ishin mbivlerësuar për 113,756€;
- A1 Nēnvlerësim i llogarive të arkëtueshme në raportin vjetor financiar në vlerë 34,376€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Vushtrrisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B5 Në shtatë raste të obligimeve në vlerë 81,978€, kishte vonesa në pagesës nga 5 deri 95 ditë pas afatit të lejuar për pagesë;
- A2 Në dy pagesa në vlerë 68,756€, ishin bërë ndryshime në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal;
- B6 Në një rast të procedurës së prokurimit, ishin aplikuar kriteret favorizuese në specifikat e dosjes së tenderit;
- C1 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme;
- B7 Mos pagesa e qirave mujore nga shfrytëzuesit e pronave publike;
- B8 Në dy raste, kishte mangësi në monitorimin e raportimeve nga përfituesi i subvencionit;
- B9 Në pesë raste kishte dobësi në procesin e dhënies së subvencioneve për përfituesit individual.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gjatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vushtrrisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vushtrrisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vushtrrisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vushtrrisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar janë: prezantimi jo i drejtë i shpenzimeve, pasuritë, obligimet e papaguara, detyrimet kontigjente, si dhe llogaritë e arkëtueshme për shkak të regjistrave të pasaktë. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte dobësi tek ridestinimi i projekteve kapitale, procesi i dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, procesi i prokurimit, mos verifikimi i 20% të pronave të tatueshme si dhe vonesa në pagesën e faturave.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 16 rekomandime, prej tyre 4 janë rekomandime të reja, 11 rekomandime të përsëritura dhe 1 rekomandim i përsëritur pjesërisht.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" neni 18, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në 16⁵ pagesa në vlerë prej 774,368€ kemi identifikuar se komuna përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate si në vijim:

- Përmes vendimeve gjyqësore përmbartimore ishin ekzekutuar shpenzime në vlerë 658,353€ për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta. Nga kjo vlerë, 547,313€ ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale, 50,131€ nga mallrat dhe shërbimet si dhe 60,909€ nga kategoria e subvencioneve;
- Po ashtu përmes vendimeve gjyqësore, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin paguar 75,000€ për ndërtimin e shtratit të lumit, shpenzime që për nga natyra i takojnë investimeve kapitale, si dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 41,015€ € për asfaltim të rrugëve, shpenzime që për nga natyra i takojnë po ashtu investimeve kapitale.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe vonesave në pagesën me kohë të obligimeve.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo

adekuate, ndikon në mbivlerësim/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke shkaktuar prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjet adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlerësim i regjistrit të pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja Rregullorja MF Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, paragrafi 3, përcakton që: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria".

Pasuritë e blera gjatë vitit 2024 dhe investimet në vijim nuk ishin regjistruar në regjistrat përkatës të pasurisë jo financiare, duke e nënvlerësuar vlerën e pasurisë në raportin vjetor financiar për 651,807€⁶. Në vijim, janë prezantuar detajet:

- Investime në vijim të paguara gjatë vitit 2024 për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe fushave sportive, në vlerë 607,516€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale të SIMFK-së si pasuri në vijim; si dhe
- Pasuri jokapitale të teknologjisë informative dhe pajisje të tjera, të blera gjatë vitit 2024 në vlerë 44,291€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme me rastin e regjistrimit të pasurisë dhe mos komunikimit të mirëfilltë mes drejtorive për bartjen e informative në lidhje me blerjet e vitit. Vlen të përmendet se komuna na ka ofruar dëshmi për regjistrimin e këtyre pasurive në regjistrin e pasurisë në vitin 2025, por këto ndryshime nuk ishin reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2024.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive të investimeve në vijim dhe pasurive jokapitale ndikon që vlera e pasurive të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive dhe komunikim mes drejtorive ashtu që pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente

Gjetja Rregullorja e MF Nr.01/20217, për raportim vjetor financiar, Neni 6, parasheh se: “Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”, ndërsa neni 18 përcakton që organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin financiar vjetor ishin mbivlerësuar për 129,431€, për shkak se komuna kishte prezantuar në regjistrin e detyrimeve kontigjente katër⁷ pretendimet për kompensime të pagave, për të cilat kishin përfunduar procedurat gjyqësore dhe ishin marrë vendimet përfundimtare nga gjykata. Këto shpenzime do të duhej të përfshiheshin si obligime në regjistrin e obligimeve të papaguara.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrës ligjore dhe asaj të financave si dhe funksionimi jo efikas i kontrolleve të brendshme në përditësimin e regjistrave kontabël.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontigjente në vlera jo të sakta ndikon në mbivlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e raportin vjetor financiar të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve kontigjente.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë përfundimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara në raportin vjetor financiar**

Gjetja Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, Neni 6 parasheh se: “Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Obligimet e papaguara nuk janë prezantuar saktë në raportin vjetor financiar, pasi që tri (3)⁸ fatura në vlerë 113,756€ të cilat ishin paguar nga komuna me datë 12 dhe 18 dhjetor 2024, ishin shpalosur si obligime të papaguara.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në menaxhimin dhe përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara nga zyrtarët përgjegjës financiar.

Ndikimi Mbivlerësimi i obligimeve të papaguara ndikon në pasaktësi në raportin vjetor financiar dhe që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën tyre.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në azhurnimin e regjistrit të obligimeve të papaguara në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë

dhe i plotë i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja

Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, nenit 6, parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10 paragrafi 1 përcakton se: "Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: pika 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës".

Në tetë (8)⁹ raste, komuna ka bërë prezantim jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF, me ç' rast regjistri i llogarive të arkëtueshme në raportin vjetor financiar ishte nënvlerësuar për 34,376€. Detajet e këtyre gabimeve janë si në vijim:

- Në katër (4) raste tek taksa për lejet ndërtimore kishte nënvlerësim për 60,364€, pasi që komuna nuk ka shpalosur këstet e papaguara për lejet ndërtimore;
- Po ashtu, në katër (4) raste tjera tek dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, ishin mbivlerësuar llogaritë arkëtueshme për 9,165€, si rezultat i mos azhurnimit të regjistrit;
- Në dy (2) raste me vlerë 16,823€ tek tatimi në pronë për parcela kishte mbivlerësim, komuna kishte ngarkuar me tatim në pronë tokat në pronësi publike, duke mbivlerësuar regjistrin e llogarive të arkëtueshme për këtë shumë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Nënvlerësimi dhe mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme ndikon në prezantim jo të saktë të informatave në raportin vjetor financiar të komunës dhe që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën tyre.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B5 - Vonesë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve

Gjetja Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), nenit 39.1 parasheh që: “ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore”.

Në shtatë (7)¹⁰ raste, në vlerë prej 81,978€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor. Vonesat ishin nga 5 ditë deri në 95 ditë pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo kishte ndodhur kryesisht si rezultat i mungesës së mjeteve financiare për shkak të pagesave të pa planifikuara përmes vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e faturave mund ta bëjë komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhet brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

Gjetja Ligji Nr. 08-L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2024, neni 16, pika 11, përcakton që: "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal"

Në dy (2)¹¹ pagesa të projekteve kapitale në vlerë prej 68,756€, ishin marrë fondet nga projekte tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Këto ndryshime në shumat e ndara buxhetore ishin bërë me vendim të Kryetarit të Komunës pa marrë aprovimet e Kuvendit Komunal për ridestitim të fondeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos përgjegjësisë së menaxhmentit të komunës për të zbatuar kërkesat e ligjit të buxhetit lidhur me ndryshimet buxhetore.

Ndikimi Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal mund të reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimet e marra rreth shfrytëzimit të fondeve publike. Po ashtu, mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese duke pamundësuar financimin e

mjaftueshëm të tyre.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Dobësi në procedurat e prokurimit publik

Gjetja Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, neni 28, pika 2, përcakton që: autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Në procedurën e prokurimit "Blerje furnizim dhe montimi i kalldas me qiler në QMF-1" në vlerë 62,062€, komuna me rastin e përcaktimit të specifikave në dosjen e tenderit, tek pjesa B, pozicioni 1, ishin përdorur marka tregtare apo emra të prodhuesit MECO për ventilatorët-konvektorëve, pa përdorur edhe termin të ngjashëm, duke përdorur kriterë favorizuese të cilat kishin eliminuar konkurrencën.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta me rastin e përpilimit të specifikimeve teknike nga ana e njësisë kërkuese dhe zyrës së prokurimit.

Ndikimi Vendosja e kriterëve favorizuese në specifikime teknike shkakton trajtim jo të barabartë apo diskriminimin e operatorëve ekonomik dhe dëmton konkurrencën.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj kontrolle efektive tek njësitë kërkuese dhe zyrën e prokurimit me qëllim që gjatë hartimit të specifikave teknike të mos përdoren kriterë favorizuese për të siguruar që procedurat e prokurimit zhvillohen në pajtim me ligjin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos inspektimi i 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 15, parasheh se: "Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës".

Komuna gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur të bëjë inspektimin apo verifikimin e së paku 20% të pronave të regjistruara brenda territorit të Komunës, mirëpo brenda vitit kishte bërë inspektimin e vetëm 9.5% të pronave të përgjithshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe angazhimeve të pamjaftueshme për verifikimin e pronave sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos inspektimi i pronave rezulton me informata jo të plota të pronave aktuale dhe me ndikim në vlerësim jo të drejtë dhe të saktë të ngarkesave për tatimin në pronë, respektivisht pranime më të ulëta të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mos pagesa e rregullt e qirasë nga shfrytëzimi i pronave publike

Gjetja Kontrata e qirasë, pika 7.1 specifikon se, nëse qiramarrësi dështon të paguajë obligimet e papaguara, apo dështon në zbatimin kushteve të kontratës, atëherë qiradhënësi e njofton qiramarrësin për mos përmbushjen, dhe nëse qiramarrësi nuk e përmirëson dështimin brenda 15 ditëve, atëherë kontrata qirasë automatikisht do të konsiderohet se ka përfunduar.

Gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme për shfrytëzimin e pronave publike të Komunës, kemi identifikuar mangësi në menaxhimin e kontratave me qiramarrësit si në vijim:

- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00127-0, për aktivitete afariste 90m², e nënshkruar në 02.02.2017 me afat të shfrytëzimit për shtatë (7) vite dhe me qira mujore 1,000€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës, qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 30,000€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00209-0, për aktivitete bujqësore 23.45ha e cila gjendet në fshatin Gracë, e nënshkruar në 02.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira vjetore 7,070€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 5,411€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00492-0, për aktivitete bujqësore 11.97ha e cila gjendet në fshatin Balincë, e nënshkruar në 01.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira vjetore 898€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 4,118€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00492-0, për aktivitete bujqësore 8.85ha e cila gjendet në zonën kadastrale në Dobërllukë, e nënshkruar në 31.10.2016 me afat të shfrytëzimit për 10 vite dhe me qira vjetore 974€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 2,016€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokën për afarizëm e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00653-0, për aktivitete afariste 13m² e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 01.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 5 vite dhe me qira mujore 132€. Si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës

- qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,860€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afarist i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-2254/49, për aktivitete afariste 16m² e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 03.02.2016 me afat të shfrytëzimit për 5 vite dhe me qira mujore 32€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,504€;
 - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-412-1, për aktivitete afariste 3.24ha e cila gjendet në fshatin Lum Madh, e nënshkruar në 15.03.2016 me afat të shfrytëzimit për 3 vite dhe me qira vjetore 583€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,458€;
 - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-1108/19, për aktivitete afariste 8.61m² e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 04.12.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira mujore 34€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,284€;
 - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00001-1, për aktivitete afariste 25.2m² e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 04.12.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira mujore 73€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 369€.

Shkaku i mos përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në kontratë ishte mos përmbushja e detyrave me përgjegjësi dhe mungesa e vendosjes së një mekanizmi efektiv për monitorimin e procesit të pronave komunale të cilat janë dhënë me qira.

Ndikimi

Mos përmbushja e obligimit financiar rrit rrezikun që të pamundësohet arkëtimi i të hyrave i cili ndikon në përmbushjen e projeksioneve buxhetore. Mos marrja e veprimeve ligjore ndaj qiramarrësve të pa përgjegjshëm mund të inkurajojë të njëjtit dhe qiramarrësit tjerë të mos përmbushin obligimet kontraktuale.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë që janë vendosur kontrolle efektive për monitorimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim. Gjithashtu, për qiramarrësit të cilët nuk përmbushin kushtet e kontratës të marrë veprimet e nevojshme ligjore për mbledhjen të qirasë së pa arkëtuar nga komuna dhe të shqyrtoj mundësinë e ndërprerjes së kontratës nëse kemi të bëjmë me një shfrytëzues të pandërgjegjshëm në respektimin e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Mangësi në monitorimin e raportimeve nga përfituesi i subvencionit.

Gjetja

Marrëveshja e mirëkuptimit për financim të përbashkët në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe KBI Vushtrri, neni 2 pika 2.2 përcakton që, KBI obligohet që t'i dërgoj komunës së Vushtrrisë raport mujor në fillim të çdo muaji lidhur me progresin e marrëveshjes. Po ashtu, me marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide, neni 2 pika 2.1 ndër tjera specifikon se e njëjta do të dëshmojë faturat të shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara.

Gjatë testimit të monitorimit të subvencioneve kemi identifikuar këto mangësi:

- Në një mostër të subvencionimit për financim të përbashkët ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe KBI Vushtri, me vlerë 10,000€ përfituesi nuk kishte ofruar raportet mujore të ecursisë së projektit ashtu siç parashihej me dispozitat e marrëveshjes në mes të Komunës dhe përfituesit.
- Po ashtu në një mostër tjetër nga marrëveshja për financim të përbashkët në vlerë 75,368€ në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide, përfituesi nuk kishte ofruar raportet me fatura ashtu siç parashihej me dispozita të marrëveshjes. Pas përfundimit të auditimit, komuna na ka ofruar raportet me faturat përkatëse.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së monitorimit dhe neglizhencës nga zyrtarët përgjegjës për të mbikëqyrur implementimin dhe raportimin nga përfituesit e subvencioneve.

Ndikimi

Mungesa e monitorimit dhe raportimi i mangët nga përfituesit ndikon në shpenzimin jo efektiv të mjeteve dhe mosarritjes së qëllimit të dedikuar të subvencionimit.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë që të bëhet monitorimi dhe të sigurohen raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përfituesit që nuk kanë raportuar për mjetet e shfrytëzuara të përjashtohen nga e drejta e përfitimit të subvencioneve në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B9 - Dobësi në procesin e dhënies së subvencioneve për përfituesit individual

Gjetja

Rregullorja KKV nr.03/2023, për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare për persona fizik dhe juridik, neni 5, parasheh ndër të tjera ndihmë momentale për shërim për personat fizikë. Po ashtu, rregullorja e njëjtë, neni 6, pika 3, përcakton kriteret që duhet t'i plotësojë personi fizik përfitues, ndër të tjera: rekomandimin nga komisioni i ekspertëve i drejtorisë përkatëse bashkë me raportet mjekësore dhe diagnozën e personit dhe dëshminë mbi gjendjen e rëndë sociale të personit fizik, të verifikuar nga komisioni i drejtorisë përkatëse.

Gjatë testimit të procedurave¹⁴ të subvencionimit kemi identifikuar këto mangësi:

- Në katër (4) raste në vlerë 18,000€, të subvencionimit për shërim të personave fizik me sëmundje të ndryshme, me vendim të Kuvendit Komunal, përfituesit nuk i kishin plotësuar kriteret e parapara me rregullore, pasi që dosjeve u mungonte rekomandimi nga komisioni i eksperteve të drejtorisë përkatëse dhe dëshmia e gjendjes së rëndë sociale. Për më tepër, në dy raste në vlerë 10,000€, subvencionimi ishte bërë për trajtim jashtë vendit, jo në përputhje me rregulloren e brendshme e cila parasheh vetëm ndihmë momentale për shërim. Trajtimi i pacienteve jashtë vendit është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë përmes Fondit për Sigurime Shëndetësore, bazuar në

Ligjin nr. 04/L -249 për sigurimin shëndetësor, përkatësisht Udhëzimin administrativ (MSH) nr. 03/2023 për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

- Në një rast të subvencionimit në vlerë 3,000€ për ndihmë momentale për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, përfituesit i mungonte dëshmia e gjendjes së rëndë sociale.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos zbatimit të procedurave dhe akteve rregullative përkatëse nga ana e personave përgjegjës gjatë vlerësimit të kërkesave për subvencionim.

Ndikimi

Dhënia e subvencioneve në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe në kundërshtim me rregulloren në fuqi ndikon në trajtim jo të barabartë, rritë rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe qëllimi i subvencionimit mos të arrihet.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi dhe miratimi i kërkesave për subvencionim të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore dhe brenda fushëveprimit ligjor të komunës. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrja në procesin e vlerësimit të kërkesave për të parandaluar miratimin e ndihmave në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ose për qëllime që tejkalojnë kompetencat e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,175,845€, prej tyre në vitin 2024 ishin shpenzuar 6,569,464€. Struktura e investimeve kapitale përbëhet nga investimet në infrastrukturën rrugore, rregullimin e lumenjve, mirëmbajtjen investive, ujësjellës, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Çështja A3 - Mospërdorim i modulit në E-prokurim për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performances së kontraktuesve

Gjetja Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Në dy (2)¹⁵ kontrata në vlerë 2,844,197€, menaxherët e kontratave nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B10 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Rregullorja 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23, "Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave". Kontrata, neni 1.3 përkatësisht 1.5 përcakton që: përfundimi i të gjitha punëve do të duhej të kryheshin brenda viti 2024.

Ne kemi vërejtur se në kontratat e listuara më poshtë, kishte vonesa në

realizimin përtej afatit të përcaktuar të përfundimit të punimeve:

- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Bekim Berisha Abeja dhe rrugës Vëllezërit Feka” në vlerë 778,251€, e lidhur më 25.08.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024 kontrata ishte realizuar vetëm 67%;
- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Lumni Surdulli” në vlerë 685,260€, e lidhur më 25.08.2023 e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 79%;
- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Avni Saraçi dhe rrugën Viciana” në vlerë 250,019€, e lidhur më 25.08.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 75%;
- Kontrata “Ndërtimi i kanalizimit Lot 3” në vlerë 579,485€ e lidhur më 17.07.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 88%.

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur si rezultat i planifikimit jo të mirë dhe mos përmbushjes së kushteve për realizim të projekteve para lidhjes së kontratave, si dhe për shkak të mungesës së mjeteve për përfundimin e tyre sipas dinamikës së paraparë.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mosarritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 122,223,116€, pasurive jokapitale 235,823€, si dhe e stoqeve 34,994€.

Çështja A4 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja Rregullorja nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 11 përcakton që: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi”.

Në tetë (8) mostra në vlerë 657,981€, pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2020, për të cilat nuk është bërë ende pranimi teknik, figurojnë në regjistër si investime në vijim, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, ne nuk kemi mundur të kalkulojmë vlerën e gabimit të zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit të pasurisë në PFV.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduara që janë në përdorim nga komuna ndikon në paqartësinë e statusit të tyre duke shkaktuar vlerësim jo të drejtë dhe raportim të pa saktë të tyre.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2024 në total janë 7,495,076€. Vlera e të arkëtueshmëve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, leje ndërtimore, taksat për biznese, qiraja nga shfrytëzimi i pronave komunale, etj.

Çështja B11 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 27 përcakton që: “Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”. Po ashtu, Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, neni 7, pika 3, përcakton se “Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave, për çdo muaj të vitit ose me këste. Më tutje, Vendimet përkatëse të nxjerra nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, përcaktojnë afatet e pagesave të kësteve për leje ndërtimore.

Llogaritë e arkëtueshme, në krahasim me vitin 2023, kanë shënuar rritje për 15.45%, apo 998,282€. Rritja kishte ndodhur te tatimi në pronë 33% dhe taksa për grumbullimin e mbeturinave 17%.

Në 19 raste të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 275,451€, në nëntë (9) raste të lejeve ndërtimore në vlerë 349,473€ dhe në 13 raste të taksës për grumbullimin e mbeturinave në vlerë 3,902€ komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbauesit për mbledhjen e këtij borxhi, edhe pse ishte tejkaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe afati në shkresat për rikujtimin e borxhit.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos inkasimi i të arkëtueshmeve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B11

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁶	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	26,770,039	29,388,678	27,485,167	26,213,118	18,327,419
Grante Qeveritare - Buxheti	23,351,885	24,380,001	23,348,947	21,238,617	15,281,820
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	158,056
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,560,105	1,367,218	2,561,003	1,426,001
Të hyrat vetanake	3,418,154	3,418,154	2,754,605	2,411,650	1,392,598
Donacionet vendore	0	6,200	2,000	1,848	48,236
Donacionet e jashtme	0	24,217	12,396	0	20,707

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,618,639€. Kjo rritje është rezultat i mjeteve shtesë nga granti qeveritar prej 1,028,117€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 1,560,105€ dhe donacioneve 30,417€.

Në vitin 2024 Komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar, me një rënie në realizim të buxhetit prej prej 1% krahasuar me vitin 2023, ku realizimi ishte 95%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	26,770,039	29,388,678	27,485,167	26,213,118	18,327,419
Pagat dhe mëditjet	13,209,301	14,270,147	14,268,929	12,140,868	10,100,514
Mallrat dhe shërbimet	4,840,000	5,122,737	4,932,574	4,416,993	3,306,294
Komunalitë	571,000	580,268	486,810	447,458	381,075
Subvencionet dhe transferet	1,223,000	1,238,680	1,227,390	1,129,213	1,183,529
Investimet Kapitale	6,926,738	8,176,845	6,569,464	8,078,586	3,356,007

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,060,846€. Kjo rritje vjen kryesisht për mbulimin e obligimeve që kanë rrjedh nga kontrata kolektive.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 282,737€, në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat bartjes së të hyrave vetanake dhe donacioneve për mbulimin e nevojave të komunës për shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa, ekzekutimi i buxhetit në këtë kategori ishte 96%.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte rritur për 9,268€ me buxhetin fillestar. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit kishte arritur mbi 84%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 15,680€, në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen për subvencionimi e fermerëve, subvencionimin e kulturës, arsimit dhe sportit nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe donacioneve. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 99% e buxhetit final.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 1,250,107€. Kjo rritje ishte për financimin e projekteve kapitale që do përmirësojnë infrastrukturën e komunës. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 80%, për shkak se disa projekte kishin mbetur pa realizuar për arsye të vonësive që kanë ndodhur gjatë realizimit të kontratave, si rezultat i problemeve pronësore apo uzurpimi i pronës publike.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2024 ishin në vlerë prej 2,975,945€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i hapësirës publike. Për vitin 2024, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 3,418,154€, me një ngecje në realizim për 442,209€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave, ka ulje prej 432,078€, që kryesisht i përket të hyrave të tatimit në pronë.

Në shumën totale të pranimeve për vitin 2024, nuk janë të përfshira edhe të hyrat nga gjobat në trafik, gjobat nga Gjykatat dhe Agjencioni i Pyjeve në vlerë prej 595,536€, të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), e të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	3,418,154	3,418,154	2,975,945	3,408,023	2,569,400
Të hyrat tatimore	1,333,527	1,333,527	665,169	1,268,599	969,623
Të hyrat jo tatimore	2,084,627	2,084,627	2,310,775	2,138,724	1,599,777
Të hyrat tjera	0	0		700	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2023 të Komunës së Vushtrrisë ka rezultuar me 27 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, 15 rekomandime janë zbatuar, 11 rekomandime nuk janë zbatuar dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë dhe i plotë në PVF.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e qirasë për shfrytëzimin e pronave publike përmbushen nga qiramarrësit sipas kushteve kontraktuale, dhe në rast dështimi, kontratat e qirasë të ndërpriten. Për borxhet e papaguara të ndërmerren veprime ligjore për inkasimin e tyre.	Komuna nuk ka ndërmarr veprimet të nevojshme për adresimin e rekomandimit.	Nuk ka filluar zbatim

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike për projektet kapitale nuk tejkalojnë shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore, dhe shumat e planifikuara në planin vjetor të prokurimit	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që te kontrata me peshim të mos aplikohet rritja prej 30% te vlerës së kontratës bazë. Gjatë realizimit të kontratës, të ruhet e njëjta përqindje apo raport i peshimit të kategorive/pozicioneve siç janë kontraktuar.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se kalkulimi i zbritjeve nga baza tatimore e pronave me vendbanim parësor aplikohet saktë, dhe se veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha pronave/objekteve brenda territorit të Komunës.	Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme, ndërsa sa i përket bazës së tatimpaguesve komuna kishte ndërmarr veprime të nevojshme.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për të siguruar plotësimin dhe përditësimin e të dhënave për tatimpaguesit në sistemin ProTax.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se procedurat e rekrutimit të punonjësve zhvillohen sipas kërkesave ligjore dhe kritereve të përcaktuara me konkursin publik. Të përmirësohen kontrollet e brendshme në organizimin e testit me shkrim, dhe se në kontratat me afat të caktuar të përcaktohet saktë afati kohor i angazhimit.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të vonesave në pagesë të faturave.	Nuk ka filluar zbatimi

9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që në Marrëveshje të përcaktohen saktë specifikimet teknike që kanë të bëjnë me lokacionet, hapësirat punuese, orarin ku do të kryhen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, si dhe numrin e punonjësve që do të angazhohen në ofrimin e atyre shërbimeve.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se procesimi i pagesave bëhet vetëm pasi të jetë konstatuar se faturat përmbajnë çmimet e sakta ashtu siç janë kontraktuar.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
11.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas kërkesës së rregullore përkatëse.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të duhura për forcimin e kontrollit të brendshme në mënyrë që kërkesat për dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme për subvencione.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planit vjetor për subvencionim dhe i njëjti të dërgohet te zyra e qeverisjes së mirë në ZKM, si dhe përgatitjen dhe publikimin e raportit vjetor për përfituesit e subvencioneve sipas kërkesës rregullative.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
14.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që procesi i vlerësimit për subvencione të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrje publike për subvencione.	Komuna ka ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e rekomandimit.	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kontraktimi i punëve për projektet kapitale të bëhet duke zbatuar llojin adekuat të procedurës së prokurimit publik. Rekomandimet e KRPP-së të merren në konsiderohet dhe të zbatohen nga zyra e prokurimit. Të shtohen kontrollet në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Edhe këtë vit janë identifikuar mangësi, duke mos zbatuar procedurën adekuate të prokurimi apo duke përdorur emra tregtar.	Nuk ka filluar zbatimin

16.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që fondet publike për blerje të përdoren në mënyrën më ekonomike duke mundësuar që të merret vlera për para. Automjetet e dedikuara për njësinë e zjarrëfikjes të jenë në përputhje me kërkesat e UA (MPB) nr. 08/0219.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
17.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar hartimi i projekteve ekzekutive.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
18.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike të realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve tjera kontraktuale. MK për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave, dhe në rastet kur ato janë të paarsyetuara, të aplikohen penalet. Gjithashtu, drejtorja e financave përmes sistemi PIP, në baza tremujore, të raportoj për progresin fizik dhe financiar në departamentin e buxhetit.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe këtë vit kemi hasur që projektet kapitale nuk janë realizuar sipas afat të kontraktuar.	Nuk ka filluar zbatimin
19.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike nuk arrijnë të përfundohen brenda periudhës së kontraktuar, siguria e ekzekutimit të kontratës vazhdohet edhe për një periudhë shtesë në të cilën parashihet finalizimi i kontratës. Pagesat përmbyllëse të kontratave të mos realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar i kualitetit të punimeve.	Komuna kishte marrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim, nga mostrat e testuara ne nuk kemi hasur në ndonjë rast ku sigurimi ekzekutimi të ketë skaduar.	I zbatuar
20.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë së menaxherët e kontratave zbatojnë në tërësi kushtet e veçanta të kontratës, dhe nga secila pagesë e situacioneve të aplikojnë mbajtjen e parasë në 10% të vlerës në rastet kur nuk ofrohet garanci bankare nga kontraktuesit.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
21.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara,	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
22.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse në përputhje me planin kontabël.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi rastet ku shpenzimet janë keq klasifikuar.	Nuk ka filluar zbatimin

23.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari i pasurisë të regjistrojë të gjitha pasuritë kapitale në SIMFK, dhe pasuritë jokatipale në e-pasuri. Pasuritë e regjistruara si investime në vijim, e të cilat kanë përfunduar si projekte, të ri-alokohen në kodet përkatëse të pasurisë që i takojnë.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
24.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që LLA vazhdojnë të rriten dhe komuna nuk zbaton masat e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
25.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës ruajnë dhe sigurojnë dhe mirëmbajnë dokumentacionin burimor për të hyrat nga taksa në biznes. Ndaj borxhlinjve të ndërmerren veprime ligjore për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
26.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e papaguara prezantohen drejtë dhe saktë në PVF.	Edhe këtë vit janë hasur gabime në prezantim të obligimeve në PVF.	Nuk ka filluar zbatimin
27.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin në tërësi të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe që NjAB-në ta plotësojë me numrin e mjaftueshëm të auditorëve.	Komuna ka ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e rekomandimit.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Donjeta Rama, Anëtare e ekipit



Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2024
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Data: 03.06.2025, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Vendime gjyqësore specifikac 2, 109,383€, Vendim gjyqsor specifikacion 106,779€, Specifiacion 74,407€, Specifikacion 35,600€, VGJ specifikacion 33,102€, BD TRADE SHPK 75,000€, VGJ Specifikacion 90,909€, Vendime Gjyqësore 21,364€, Vendime Gjyqësore/Specifikacion 20,843€, Vendime Gjyqësore specifikacion 32,978€, NPSH Bageri 25,000€, Vendim Gjyqësore/specifikacion 20,000€, Vendime Gjyqësore 17,138€, Specifikacion 18,315.01€, NNT ABC SH.P.K 15,000€, Specifikacion 20,372€ .
- ⁶ Blerjet të projektorëve për shkollën e mesme teknike (më pak se 1000€) 3,641€, Fusha sportive 38,919€, Ndërtimi i rrugës "Bekim Berisha ABEJA 152,235€, Ndërtimi i rrugës "Bekim Berisha ABEJA 224,361€, Paisje tjera të teknologjisë informative dhe të komunikimit 3,600€, Ndërtimi i trotuareve fsh. Deberllug, Stanoc, Akraštice 40,000€, Paisje për kompjuter 23,426€, Paisje tjera 8,932€, Paisje tjera të teknologjisë informative dhe të komunikimit 4,692€, Riasfaltimi i rrugës R220 para fillimit të urës deri të Llamkosi 38,000€, Ndërtimi i rrugës "Lumni Surdulli" 113,999€
- ⁷ C.nr. 292-2022 në vlerë 44,826 euro, CPP NR. 82/2024 në vlerë 27,316.61euro, CPP nr. 79/2024 në vlerë 30,197.48euro, dhe CPP nr.76/2024 në vlerë 27,191euro
- ⁸ Rehabilitimi i rrugës nga magjistratja deri në Dumnicë të Epërme 50,000 € ishte paguar më 12.12.2024, Rrugë lokale 45,000€ ishte paguar më 12.12.2024, Rehabilitimi i rrugës Dëshmorët e Kombit 20,000 ishte paguar më 18.12.2024.
- ⁹ Premium Building SH.P.K me vlerë 19,075€, Dijari Estate SH.A me vlerë 26,121€ dhe Ariani Company SH.P.K me vlerë 15,187€; Kontratat për Qiratë nga shfrytëzimi i pronave publike - Bujqësi; Muharrem Syla me vlerë 7,907€, Mehdi Neziri me vlerë 1,171€ dhe Nazmi Januzi me vlerë 162€ . Tatimi nëpronë - Parcela; Republika e Kosovës me vlerë 6,213€ dhe Komuna e Vushtrisë me vlerë 10,610€
- ¹⁰ "Shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse" në vlerë 3,065.00 Euro , "Material për zyre " në vlerë 5,521.00 Euro , "Furnizime mjekësore " në vlerë 6,978.68 Euro, " Furnizim me veshmbathje" në vlerë 8,000.00 Euro , " Furnizime mjekësore-Reagencia" në vlerë 15,000.00 Euro, "Furnizime për zyre " në vlerë 4,564.00 Euro
- ¹¹ Asfaltimi i rrugës Gracë, 16,722€, Asfaltimi i rrugës Kollë, 18,756€
- ¹² Mentor Hajrizi 369 euro, Naim Jetullahu 1,284 euro, Bajram Ibrahim B.I 1,504 euro, Fatmir Ferizi 30,000 euro, NSH"Lotaria e Kosoves" Ramadan Veseli 1,860 euro, Muharrem Syla 5,411 euro, Mehdi Neziri 1,458 euro, Nazmi Januzi 2,016 euro, BLEAK ROSE SH.P.K 4,118 euro.
- ¹³ KBI Vushtrri 10, 000 euro. Projekti i themelimit të portalit të Këshillit të Bashkësisë Islame Vushtrri. ISLAMIC RELIEF NDERTIMI I SERRAVE 75,68 euro.
- ¹⁴ Engjell Grabanica 5,000 euro, Remzi Rashica 5,000 euro, Drilon Haradinaj 5,000 euro dhe Nasuf Aliu 3,000 euro, Hamit Sejdiu 2,000 euro.
- ¹⁵ Ndërtimi i projektit Udha e Gurit 359,717€ dhe Mirembajta e objekteve të AK 2,486,480€
- ¹⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUSHTRRI

Nr. / Br. 29927/25

Nr. i fq. / Br. st. 1

Data: / Datum: 01.07.25

VUSHTRRI - VUCHITEN



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE :	01.07.2025
REFERENCE:	10 Nr. /25
PËR:	KPF dhe KK, Vushtrri
PËRMES:	Ferit Idrizi,  Kryetar i Komunës
NGA:	Drejtori i DKA-së, Albanez Tahiraj 
TEMA:	Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2024/2025

Drejtorja Komonale e Arsimit në Vushtrri bazuar në Rregulloren (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë, paraqet këtë Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2024/2025. Komisioni punoi në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës Nr.428/2025 të datës 02.04.2025, Konkursin për ndarjen e bursave Nr.220/25 të datës 18.03.2025.

Përmbajta:

I.	Informata të përgjithshme.....	3
II.	Lista përfundimtare të aplikantëve (fitues dhe jo fitues) të bursave komunale për vitin akademik 2024/2025- Bursa për studentë brenda vendit.....	4
III.	Bursa për studentë jashtë vendit.....	12
IV.	Bursa për studentë të vendeve të Bashkimit Evropian.....	13
V.	Përfitues të bursave që kanë tepruar brenda vendit.....	13
VI.	Përfitues të bursave që kanë tepruar jashtë vendit.....	14
VII.	Shqyrtimi i ankesave të bursave.....	16

I. Informata të përgjithshme:

- **Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/c për studime brenda vendit;
- **Numri i bursave jashtë vendit - 15 (pesëmbëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës- 1000.00 € (një mijë euro) për student/e për vendet e BE-së;
- Konkursi i bursave ka qenë i hapur nga data: 18.03.2025 - 01.04.2025
- Komisioni i ndarjes së bursave është përbërë nga: Enver Bajrami, kryesues i komisionit, Sadete Gërguri, anëtare e komisionit dhe Hashim Hajrizi, anëtar i komisionit;
- Komisioni i ankesave për studentë të cilët nuk kanë përfituar bursë është përbërë nga: Musaj Tërbunja, kryesues, Arianit Jashari, anëtar, dhe Bastri Duraku, anëtar;
- Gjithsej aplikantë të bursave 180, prej tyre 39 kanë aplikuar për drejtimet të cilat nuk i kemi shpallur. Fitues të bursave 85 studentë.
- Më datë: 02.04.2025 u pranua dokumentacioni i aplikantëve;
- Më datë: 11.04.2025 u futën të gjitha të dhënat në databazë dhe bashkë me komisionin është bërë renditja sipas notës mesatare dhe drejtimeve;
- Më datë: 15.04.2025, komisioni shpalli listën jo- përfundimtare të bursave:
- Më datën: 28.04.2025 komisioni i ankesave shqyrtoi 14 ankesa,
- Më datën: 30.04.2025 është shpallë lista përfundimtare e bursave;
- Në konkurrencë brenda vendit kanë tepruar 15 bursa dhe janë bartur në këtë kategori duke u bazuar në notën mesatare;
- Ndërsa jashtë vendit
- kanë tepruar 2 bursa dhe janë bartur në këtë kategori duke u bazuar në notën mesatare;
- 39 studentë kanë konkurruar nga drejtimet të cilat nuk i kemi shpallur;
- Përfitues të bursave sipas gjinisë: 57 janë studente, dhe 28 janë studentë;

Të gjithë kandidatët fitues/e, komisioni i renditi në bazë të notës mesatare, mbështetur në rregullore. Në drejtimet që kanë tepruar bursat, komisioni vendosi në bazë të konkursit që bursat që kanë tepruar brenda vendit të krijohet lista e atyre që i kanë plotësuar kriteret dhe në bazë të numrit që kanë tepruar tu jepet bursa. Ndërsa edhe bursat jashtë vendit që kanë tepruar tu jepen vetëm studenteve jashtë vendit .

II. Lista përfundimtare e aplikantëve (fitues dhe jo fitues), të bursave komunale për vitin akademik 2024/2025

-Bursa për studentë brenda vendit

Drejtimi: Matematikë, numri i bursave Baçelor: 2 , Master:1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Gresa Niman Jashari	Matematikë	Fitues
2	Erionë Mehdi Neziri	Matematikë	Fitues
3	Edona Shyti Fetahu	Matematikë	Jo fitues

Ndërsa në studimet; master: 1 bursë, nuk e ka fituar,

Edona Shyti Fetahu nuk ka fituar bursë pasi që ka fituar bursë nga MASHTI nga bursat elitare me Nr. vendimi 3582, datë 11.12.2024 me numër rendor 1480.

Drejtimi: Kimi, numri i bursave Baçelor: 2 , Master:1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Blerina Hamit Halili	Kimi	Fitues
2	Blenda Fatmir Neziri	Kimi	Fitues

Ndërsa në studimet; Master: 1 bursë, nuk ka pasur aplikantë.

Në drejtimin Kimi kanë qenë vetëm 2 kandidatë të cilët të dytë kanë përfituar bursën.

Drejtimi: Fizikë, numri i bursave Baçelor: 2			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
	/	/	/

Në drejtimin Fizikë, 2 bursa baçelor nuk ka pasur aplikantë.

Bursa e mbetur kalon te Përfituesit të bursave që kanë tepruar brenda vendit:

Drejtimi: Biologji , numri i bursave Baçelor: 3 , Master:1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Zana Besim Gërxhaliu	Biologji	Fitues
2	Shkëlqesa Sabri Avdiu	Biologji	Fitues

Ndërsa, 1 bursë baçelor dhe 1 bursa master nuk ka pasur aplikantë. Bursa e mbetur kalon te Përfituesit të bursave që kanë tepruar brenda vend.

Drejtimi: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane , numri i bursave Baçelor: 2:			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Elda Shefki Krasniqi	Gjuhë gjermane	Fitues
2	Labinot Fahri Gashi	Gjuhë gjermane	Fitues

Në drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Gjermane kanë qenë vetëm 2 kandidatë të cilët të dytë kanë përfituar bursën.

Drejtimit: Shkenca Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri, Inxhinieri Kompjuterike dhe sofuerike, numri i bursave Baçelor: 15 , Master:3			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Lora Bedredin Mulaku	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Fitues
2	Arianit Skender Mustafa	Shkenca Kompjuterike	Fitues
3	Leona Kadri Berisha	Inxhinieri softuerike	Fitues
4	Elma Jeton Ahmeti	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Fitues
5	Erza Shyqyri Ademi	Erza Shyqyri Ademi	Fitues
6	Lorik Fatmir Zabërgja	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
7	Qëndrim Isuf Zabërgja	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
8	Shkurta Haradin Shyti	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
9	Erëza Arben Basholli	Shkenca Kompjuterike	Fitues
10	Leonita Lulzim Kajtazi	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
11	Erza Nexhmedin Peci	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
12	Stina Xhavit Haziri	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
13	Alketa Qazim Islami	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
14	Shkurta Mehmet Basholli	Shkenca Kompjuterike	Fitues
15	Gentrit Jusuf Ahmeti	Shkenca Kompjuterike	Fitues
16	Bahrie Naim Veseli	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
17	Vlera Gadaf Mulaku	Applied Information Technology	Jo fitues
18	Elton Bajram Pajaziti	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
19	Hana Bekim Dallku	Shkenca Kompjuterike	Jo fitues

20	Olta Besnik Bunjaku	Shkenca Kompjuterike	Jo fitues
21	Gentiana Xhafer Mehana	Shkenca kompjuterike dhe Inxh.	Jo fitues
22	Taulant Bashkim Mehana	Shkenca kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
23	Medina Hajrullah Pantina	Shkenca kompjuterike	Jo fitues
24	Erisa Fevzi Osmani	Shkenca kompjuterike	Jo fitues
25	Shefikie Gani Segashi	Shkenca kompjuterike	Jo fitues
26	Erona Muharrem Maxhuni	Shkenca kompjuterike dhe Inxh.	Jo fitues
27	Adonis Ali Xhemajli	Inxhinieri Kompjuterike	Jo fitues
28	Rinor Ramadan Abazi	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Jo fitues
29	Arxhentë Bashkim Kadriu	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
30	Altina Musli Lushaku	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Jo fitues
31	Rinesa Rizah Merovci	Shkenca kompjuterike	Jo fitues
32	Leutrim Fetah Hajdini	Inxh. kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
33	Erza Avni Ademi	Shkenca kompjuterike dhe inxh.	Jo fitues
34	Medina Veton Shabani	Inxhinieri kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
35	Rona Avdyll Maxhuni	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
36	Indrit Jeton Salihu	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Jo fitues
37	Rinesa Sami Sallahu	Shkenca kompjuterike dhe inxh.	Jo fitues
38	Pënar Turhan Kera	Shkenca kompjuterike	Jo fitues
39	Erleta Sabri Parduzy	Shkenca Kompjuterike/Inxhinieri softuerike	Jo fitues
40	Qëndresë Safet Mehana	Shkenca kompjuterike	Jo fitues
41	Yllza Ferki Mehana	Shkenca kompjuterike dhe Inxh.	Jo fitues
42	Erina Fevzi Mjeku	Shkenca Kompjuterike	Jo fitues

Në Drejtimet: Shkenca Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri, Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike, kanë aplikuar 42 studentë, ndërsa kanë përfituar 15 në studimet Bachelor. Ndërsa në studimet; Master: 3 bursë, nuk ka pasur aplikantë. Bursa e mbetur kalon te Përfituesit të bursave që kanë tepruar brenda vendit.

Kandidatët që kanë qenë të renditur lartë më notën mesatare por nuk kanë përfituar pasi që kanë përfituar bursë tjetër:

Vlera Gadaf Mulaku, studente - Applied Information Technology nuk ka përfituar bursë komunale (edhe pse ka qenë e renditur lart me notë mesatare) sepse ka përfituar bursë nga MASHTI-Për përfitues të bursave për studentët në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (apo STEM) të arsimit të lartë në Kosovë ,2024/2025, Numër: 01B- 3640 Data: 13.12.2024, E renditur me numër 1540. Pasi që Rregullorja (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 4 pika 3. Bursa mund të përfitojnë vetëm studentet që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucionet tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

Elton Bajram Pajaziti, studente Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike , nuk ka përfituar bursë komunale (edhe pse ka qenë e renditur lart me notë mesatare) sepse ka përfituar bursë elitare nga MASHTI 2024/2025 me numër 0/B-228, datë: 11.12.2024 me numër rendor 1313. Pasi që Rregullorja (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 4 pika 3. Bursa mund të përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucionet tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

Hana Bekim Dallku, studente Shkenca Kompjuterike- Universum College, nuk ka përfituar bursë pasi që nuk e ka pasur vërtetimin e regjistrimit të vitit(edhe pse ka qenë e renditur lart me notë mesatare).

Fakulteti i Ndërtimtarisë: Gjeodezi, numri i bursave Baçelor: 2			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
	/	/	/

Në drejtimin Gjeodezi, 2 bursa baçelor nuk ka pasur aplikantë. Bursa e mbetur kalon te Përfituesit të bursave që kanë tepruar brenda vendit:

Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e përgjithshme, numri i bursave Baçelor: 15			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Ejonë Bashkim Hasani	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
2	Genta Gazmend Dervishi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
3	Yllmir Sami Merovci	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
4	Leonela Sami Sallahu	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
5	Albin Avni Tahiri	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
6	Donjetë Esat Haxhaj	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
7	Enis Murteza Poturqoj	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
8	Arlinda Bahri Beqiri	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
9	Egzona Albert Parduzy	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
10	Fiona Bastri Zejnullahu	Mjekësi e përgjithshme	Fitues

11	Ardian Latif Hyseni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
12	Ermal Shemsi Hyseni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
13	Jasmina Arben Cakaj	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
14	Mirlinda Hasan Maxhuni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
15	Adea Nuha Hasani	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
16	Medina Shashivar Miftari	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
17	Genta Abit Abiti	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
18	Yllka Qenan Abazi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
19	Bleona Enver Seferi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
20	Amra Gëzim Shuku	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
21	Gëzim Ali Mustafa	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
22	Vera Shukri Xhaferi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
23	Krenar Arban Krasniqi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
24	Enisë Bylent Maxhuni	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
25	Azemine Gëzim Islami	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
26	Valsona Bajram Krasniqi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
27	Dafina Ramë Ademi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
28	Lindrit Hashim Uka	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
29	Diellza Arben Pllana	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
30	Vesa Negjmi Shallci	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
31	Erëza Bekim Bajrami	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues

Nga Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e përgjithshme, kanë aplikuar 31 studentë ndërsa kanë përfituruar 15, të tjerët kanë kaluar në bursat e mbetura brenda vendit ku edhe nga kjo kategori kanë përfituruar 9 studentë gjithsej nga Fakulteti- Mjekësi e përgjithshme kanë përfituruar 24 studentë nga 31(ose nga 27 sa e kanë merituar).

Kandidatët që kanë qenë të renditur lartë më notën mesatare por nuk kanë përfituruar pasi që kanë përfituruar bursë tjetër:

Medina Shashivar Miftari, studente Mjekësi e përgjithshme nuk ka përfituruar bursë komunale (edhe pse ka qenë e renditur lart me notë mesatare) sepse ka përfituruar bursë elitare nga MASHTI 2024/2025 me numër 0/B-228, datë: 11.12.2024 me numër rendor 1055. Pasi që Rregullorja (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 4 pika 3. Bursa mund të përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucionet tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

Genta Abit Abiti studente Mjekësi e përgjithshme nuk ka përfituruar bursë komunale (edhe pse ka qenë e renditur lart me notë mesatare) sepse ka përfituruar bursë elitare nga MASHTI 2024/2025 me numër 0/B-228, datë: 11.12.2024 me numër rendor 1551. Pasi që Rregullorja (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 4 pika 3. Bursa mund të

përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucionet tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

Yllka Qenan Abazi studente Mjekësi e përgjithshme nuk ka përfituar bursë komunale (edhe pse ka qenë e renditur lart me notë mesatare) sepse ka përfituar bursë elitare nga MASHTI 2024/2025 me numër 0/B-228, datë: 11.12.2024 me numër rendor 1149. Pasi që Rregullorja (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 4 pika 3. Bursa mund të përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucionet tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

Blcona Enver Seferi studente Mjekësi e përgjithshme nuk ka përfituar bursë komunale (edhe pse ka qenë e renditur lartë me notë mesatare) sepse ka përfituar bursë elitare nga MASHTI 2024/2025 me numër 0/B-228, datë: 11.12.2024 me numër rendor 523. Pasi që Rregullorja (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 4 pika 3. Bursa mund të përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucionet tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

Fakulteti i Mjekësisë dhe kolegjet– Stomatologji, numri i bursave Baçelor: 4			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Auron Raif Merovci	Stomatologji	Fitues
2	Aurela Burim Salihu	Stomatologji	Fitues
3	Riola Armend Kullovci	Stomatologji	Fitues
4	Anisa Adnan Klinaku	Stomatologji	Fitues
5	Kushtrim Qamil Ibishi	Stomatologji	Jo fitues
6	Leonora Bahri Duraku	Higjienë dentare	Jo fitues
7	Rinor Jeton Shabani	Stomatologji	Jo fitues
8	Viola Sami Haxhaj	Stomatologji	Jo fitues
9	Blerina Driton Sinani	Stomatologji	Jo fitues
10	Alisa Rafet Kelmendi	Stomatologji	Jo fitues
11	Aurora Kajtaz Hajdini	Stomatologji	Jo fitues
12	Alketa Bekim Xhema	Stomatologji	Jo fitues
13	Unik Ekrem Saraçi	Stomatologji	Jo fitues
14	Anita Isak Mulliqi	Stomatologji	Jo fitues
15	Natyra Fehmi Osmani	Stomatologji	Jo fitues
16	Adem Azem Ibrahim	Stomatologji	Jo fitues
17	Sejdi Bahri Karaça	Stomatologji	Jo fitues
18	Rajmonda Besim Syla	Higjienë dentare	Jo fitues
19	Drin Mustafë Mulaku	Stomatologji	Jo fitues

Nga Fakulteti i Mjekësisë dhe kolegjet – Stomatologji, kanë aplikuar 19 , ndërsa 2 studentë Leonora Bahri Duraku dhe Rajmonda Besim Syla kanë aplikuar me drejtim tjetër që nuk e kemi shpallur. Në këtë kategori kanë përfituar 4 studentë ndërsa tjerët kanë kaluar në kategorinë bursa të mbetura brenda vendit, ku kanë përfituar 4 studentë gjithsej studentë që kanë përfituar bursë nga drejtimi Stomatologji 8 nga 19.

Fakulteti i Mjekësisë dhe kolegjet –Farmaci, numri i bursave Baçelor: 4			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Drilona Fazli Rama	Farmaci	Fitues
2	Bujar Shaban Abiti	Farmaci	Fitues
3	Albiona Arben Shala	Farmaci	Fitues
4	Elsa Gëzim Rustolli	Farmaci	Fitues
5	Mjellma Shemsedin Vërbovci	Farmaci	Jo fitues
6	Adelinë Bekim Latifi	Farmaci	Jo fitues
7	Florentina Isak Shyti	Farmaci	Jo fitues
8	Elnora Jeton Shabani	Farmaci	Jo fitues
9	Blerina Ilmi Hyseni	Farmaci	Jo fitues

Nga Fakulteti i Mjekësisë dhe kolegjet –Farmaci, kanë aplikuar 9 studentë, kanë përfituar 4 studentë si dhe njëri ka qenë me Master dhe kaluar në bursa të mbetura me master brenda vendit.

Fakulteti i Arkitekturës dhe kolegjet: Arkitekturë, numri i bursave Baçelor: 5			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Dorart Isa Ismajli	Arkitekturë	Fitues
2	Amira Gazmend Gjyshinca	Arkitekturë dhe planifikim hapësinor	Fitues
3	Leart Nazmi Bajrami	Arkitekturë	Fitues
4	Ensar Ademi	Arkitekturë dhe planifikim hapësinor	Fitues
5	Anisa Ilaz Menxhiqi	Arkitekturë me specializim	Jo fitues

Në drejtimin, Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor , 1 bursë baçelor nuk ka pasur aplikantë e cila kalon te bursa e mbetur brenda vendit dhe një kandidate Anisa Ilaz Menxhiqi me Master kalon të kategoria master e bursë e mbetur brenda vendit dhe fiton bursën.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Automatikë dhe Robotikë, numri i bursave Baçelor: 3			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Shkurta Skender Bunjaku	Elektronikë Robotikë Automatikë	Fitues

Në drejtimin Automatikë dhe Robotikë, 2 bursa baçelor nuk ka pasur aplikantë dhe bursat e mbetura kalojnë me kategorinë brenda vendit.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Elektronikë, numri i bursave Baçelor: 2 , Master:1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Gresa Fatos Salihu	Elektronikë	Fitues
2	Erdona Sherif Krasniqi	Elektronikë	Fitues

Ndërsa në studimet; Master: 1 bursë, nuk ka pasur aplikantë. Kalon te bursa master e mbetur në kategorinë brenda vendit.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: Mekatronikë, numri i bursave Baçelor: 2			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Oltiana Sabri Pllana	Mekatronikë	Fitues
2	Arbnor Xhemajli	Mekatronikë	Fitues

Nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: **Mekatronikë**, kanë aplikuar 2 kandidatë dhe kanë fituar të dytë.

III. Bursa për studentë jashtë vendit

Mjekësi, numri i bursave Baçelor: 5			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Behar Shemsi Bunjaku	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
2	Dion Agim Bregaj	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
3	Eron Ramadan Merovci	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
4	Albin Shukri Xhaferi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
5	Fjolla Xhevdet Zeqiri	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
6	Anesa Ilmi Karaça	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
7	Blerta Hysni Duraku	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
8	Ema Adnan Behrami	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
9	Dea Halil Zabërgja	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
10	Erza Halil Zabërgja	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
11	Artlira Skender Spahiu	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues

Nga drejtimi Mjekësi jashtë vendi kanë aplikuar 11 studentë, kanë përfituar 5 studentë dhe 2 studentë kanë kaluar në bursat e mbetura jashtë vendi dhe kanë përfituar pra nga 11 aplikantë bursën e kanë fituar 7.

Arkitekturë: numri i bursave Baçelor: 1 , Master:1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	/	/	/

Ndërsa, 1 bursë baçelor dhe 1 bursë master nuk ka pasur aplikantë. Kjo bursë kalon në bursën e mbetur jashtë vendi.

Shkenca kompjuterike: numri i bursave Baçelor: 2 , Master:1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Ridvan Ruzhdi Pluzhina	Universiteti i Lirë I Bolzanos Itali/Shkenca kompjuterike	Fitues
2	Enes Hasan Hasani	Universiteti i Freiburgut/shkenca Kompjuterike	Fitues
3	Donat Sadri Sinani	University Freiburg, st.Master, Shkenca kompjuterike	Fitues
4	Ertrim Ekrem Grabanica	<u>City College, University of York Europe Campus, Computer Scienc e</u>	Jo fitues
5	Ajan Menduh Abazi	<u>City College, University of York Europe Campus, Computer Science</u>	Jo fitues

Nga Shkenca kompjuterike jashtë vendi kanë përfituar bursë 2 kandidatë baç dhe 1 master, dy kandidatë tjerë Ertrim Ekrem Grabanica dhe Ajan Menduh Abazi janë përfitues të bursës nga Komuna. Nr.8 me datë: 11.02.2025.

IV. Bursa për studentë të vendeve të Bashkimit Evropian

Drejttime të ndryshme:: numri i bursave Baçelor: 5			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Floriana Nuradin Beçiri	Phzik Bsc	Fitues
2.	Dafina Xaja Peci	Grazi Universitesi/Computer Engeering	Fitues
3	Diellza Habib Makiqi	Technical University of Dresden/F.Electrical and Computer	Fitues
4	Shpëtim Isuf Jashari	Information and Comp Enginderring GRAZ- Austri	Fitues
5	Festina Sabri Avdiu	University Hungary/Computer Science Engineering	Fitues

Nga drejttime të ndryshme kanë aplikuar 5 aplikantë dhe kanë fituar të gjithë.

V. Përfitues të bursave që kanë tepruar brenda vendit:

Numri i bursave 15			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Anisa Ilaz Menxhiqi	Arkitekturë me specializim	Fitues
2	Mjellma Shemsedin Vërbovci	Farmacii	Fitues
3	Amra Gëzim Shuku	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
4	Gëzim Ali Mustafa	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
5	Vera Shukri Xhaferi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
6	Kushtrim Qamil Ibishi	Stomatologji	Fitues
7	Rinor Jeton Shabani	Stomatologji	Fitues
8	Krenar Arban Krasniqi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
9	Viola Sami Haxhaj	Stomatologji	Fitues
10	Blerina Driton Sinani	Stomatologji	Fitues
11	Enisë Bylent Maxhuni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
12	Azemine Gëzim Islami	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
13	Valsona Bajram Krasniqi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
14	Dafina Ramë Ademi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
15	Lindrit Hashim Uka	Mjekësi e përgjithshme	Fitues

Bursa që kanë fituar nga bursa e mbetur brenda vendi janë 15 të renditur sipas notës mesatare.

VI. Përfitues të bursave që kanë tepruar jashtë vendit:

Numri i bursave: 2			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Anesa Ilmi Karaça	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
2	Blerta Hysni Duraku	Mjekësi e përgjithshme	Fitues

Bursa që kanë tepruar jashtë vendi kanë fituar 2 studentë bazuar në notën mesatare.

Studentët që nuk përfitojnë bursë për drejtimet që nuk i kemi shpallur;			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Eërza Ilirjan Kryeziu	FF:Evolutionary Lang Sienca	Jo fitues
2	Donjeta Beqir Kajtazi	Universum Infermieri	Jo fitues
3	Sofiye Isuf Ibrahim	Kolegji Heimerer Infermieri	Jo fitues
4	Idriz Abaz Osmani	IBCM Programim	Jo fitues
5	Enisa Abdyl Abiti	UP Arti Konceptual dhe mediet	Jo fitues
6	Gresë Abdurrahman Hetemi	IMK Makineri prodhuese	Jo fitues
7	Blerina Shefki Gërguri	FE Kontabilitet	Jo fitues
8	Ardian Ademi	Inxh. dhe teknologji ushqimore	Jo fitues
9	Rinor Qamil Maxhuni	FIEK - elektroenergjetikë	Jo fitues
10	Fatime Adem Kurti	FF. Gjuhë dhe let.frenge	Jo fitues
11	Erona Shaban Salihu	IMEK Makineri prodhuese	Jo fitues
12	Elisa Ilir Shala	Universum Infermieri	Jo fitues
13	Fortesë Xheladin Uka	IBCM Internacional Sales and Maketing	Jo fitues
14	Albion Gazmend Jashari	inxh. dhe teknologji ushqimore	Jo fitues
15	Diona Naim Kajtazi	AAB- Infermieri	Jo fitues
16	Liberta Arben Muja	UBT- Biokimi mjekësore	Jo fitues
17	Alketa Izet Kadriu	CACTUS Zhvillimi i aplikacioneve	Jo fitues
18	Albion Musa Hajriz	FE- Edukimi fizik dhe sportiv st. masteri	Jo fitues
19	Gentiana Gani Hajrizi	FE- Arsim Fillor	Jo fitues
20	Edona Blerim Kalludra	Matematikë Informatikë -Korçë Shqipëri	Jo fitues
21	Ardiana Remzi Jashari	UP.Banka dhe financa	Jo fitues
22	Filloretë Naim Uka	AAB- Infermeri	Jo fitues

23	Artina Shemsi Menxhiqi	FT. Inxh. e ndërtimit-Konstruktiv	Jo fitues
24	Eliona Milaim Shyti	TU-Inxhinieri e Mjedisit	Jo fitues
25	Anesa Avni Beqiri	FSHM -Mjekësi dentare Tetovë	Jo fitues
26	Malsor Sadri Asllani	U.Tetovë, dr.mjekësi dentare	Jo fitues
27	Egzona Shemsedin Mehmeti	IMK- inxhinieri ekonomike	Jo fitues
28	Vlera Lulzim Haradinaj	Fakulteti F. Psikologji	Jo fitues
29	Gentina Ramadan Pllana	IMK inxhinieri ekonomike	Jo fitues
30	Edona Shemsi Kodrolli	FIMK-Inxhinieri ekonomike - mekanike	Jo fitues
31	Genta Arsim Morina	Teknologji ushqimore	Jo fitues
32	Festim Musli Kasumi	Universum Infermieri	Jo fitues
33	Anita Naser Bilalli	FE. Arsimi fillor	Jo fitues
34	Alketa Haxhaj	FE. Banka financa kontabilitet	Jo fitues
35	Egzona Fehmi Mehana	IMK- inxhinieri ekonomike	Jo fitues
36	Leonita Ramdan Pllana	IMK- inxhinieri ekonomike	Jo fitues
37	Drenusha Halil Selimi	UIBM/FIMK/ Inxhinieri ekonomike	Jo fitues
38	Leonora Bahri Duraku	K.Universum- Higjenë dentare	Jo fitues
39	Rajmonda Besim Syla	Universum -Higjenë dentare	Jo fitues

VII. Shqyrtimi i ankesave të bursave:

Komisioni i ankesave për bursa është mbledhur për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga ankuesit. Komisioni është mbledhur me datë: 24, 25, dhe 28.04.2025, për të shqyrtuar ankesat e paraqitura. Komisioni i ankesave me këtë përbërje: Musaj Tërbusja-Kryesues, Arianit Jashari -Anëtar dhe Bastri Duraku Anëtar, kemi shqyrtuar në tërësi ankesat e paraqitura, brenda afatit të përcaktuar për shqyrtimin e ankesave. Komisioni njëzëri konstaton se janë 14 ankesa gjithsej, të paraqitura brenda afatit sipas tabelës më poshtë:

Komisioni i ankesave ka funksionuar në bazë të nenit 10 të Rregullores (KKV) nr. 01/2023, për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë, Konkursin për ndarjen e bursave të Komunës së Vushtrrisë Nr.220/25 të datës: 18.03.2025 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës nr. 501/25 të datës 16.04.2025.

Komisioni i ankesave ka shqyrtuar veç e veç ankesat, unanimisht i ka cilësuar si të pabazuara dhe për secilën ankesë ka marrë vendim, duke përshkruar arsyet e refuzimit.

1. Yllza Mehana, studente e Shkenca kompjuterike dhe Inxh. i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 02-104/02-0016325/25, parashtuar dhe përcjellur me nr e protokolit nga Intraneti 16325/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me a r s y e t i m Neni 6, pika 2, nënpika 2.7 i Rregullores (KKV) nr. 01/2023, për ndarjen e bursave, parasheh, që në kushte të njëjta të notës mesatare, përparësi u jepet nxënësve dhe studentëve me gjendje të rëndë sociale. Në rastin konkret aplikuesja nuk ka qenë në kushte të barabarta ngase në listën renditëse është nr 46, ndërsa 18 janë fitues.
2. Bahrie Veseli, studente, Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017503/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me A r s y e t i. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e fituesve, ku është konstatuar se e njëjta është përfituese e Bursës STEM. Bazuar në Rregulloren (KKV) nr. 01/2023, për ndarjen e bursave, Neni 4, pika 3: Bursa mund të përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës, nga institucione tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.
3. Bleona Seferi, studente e Mjekësisë së përgjithshme REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017462/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me a r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta është përfituese e bursës elitare nga MASHTI. Bazuar në

Rregulloren (KKV) nr. 01/2023, për ndarjen e bursave, Neni 4, pika 3: Bursa mund të përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës, nga institucione tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

4. Ilana Dallku, studente e Shkencë Kompjuterike i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017001/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me arsyetimi m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve. Komisioni konstaton se ankuesja ka mungesë dokumentacioni sipas konkursit për bursa: *dëshmia e regjistrimit të klasës/vitit të studimeve*. Sipas rregullores (KKV) nr. 01/2023, për ndarjen e bursave, neni 7, pika 1.1: *dëshmia e regjistrimit të klasës/vitit të studimeve me certifikatën e provimeve*; aplikuesja ka sjellë pasqyrën e notave dhe jo vërtetimin e regjistrimit të vitit të studimeve, rrjedhimisht diskualifikohet për mungesë të dokumentacionit.
5. Rinesa Merovci, studente e Shkencave kompjuterike i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/2-0017288/25, Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me Arsyetimi m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë. Pretendimet tjera të ankueses, se nga lista preliminare ka studentë që janë përfitues të dyfishtë të bursës, në rastin konkret edhe të bursës nga UMIB, nuk qëndron, ngase lista e bashkëngjitur është e përfituesve për vitin akademik 2023/24, ndërsa bursat e ofruara nga Komuna e Vushtrisë janë për vitin akademik 2024/25.
6. Erona Maxhuni, studente e Shkencë kompjuterike dhe Inxh. i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017061/25, parashtuar nga Erona Maxhuni. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me Arsyetimi m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë.
7. Aurora Hajdini, studente e Stomatologji i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017179/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me Arsyetimi m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë. Në kategorinë përkatëse janë planifikuar të ndahen 4 bursa bachelor, ndërsa ankuesja, sipas kriterëve të konkursit është renditur nr. 11.

8. Artlira Spahiu, studente e Mjekësi e përgjithshme i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017199/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me A r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë. Në kategorinë përkatëse janë planifikuar të ndahen 5 bursa bachelor, ndërsa ankuesja, sipas kriterëve të konkursit është renditur nr. 11, ndërsa vetëm 5 janë përfitues.
9. Fortesë Uka REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017111/25, parashtuar nga Fortesë Uka. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me A r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se drejtimi i studimeve nuk është në kuadër të listës deficitare të shpallur në konkursin për bursa.
10. Adelinë Latifi, studente e Farmacisë i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017109/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me A r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë brenda kategorisë ku ka aplikuar. Ndërsa në listën e bursave që kanë tepruar brenda vendit, nga 15 përfitues gjithsej, aplikuesja është renditur në listë nr 41, sipas notës mesatare dhe kriterëve tjerë të përcaktuara në konkurs.
11. Ema Behrami, studente e Mjekësisë së përgjithshme i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0016476/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me A r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë brenda kategorisë ku ka aplikuar. Ndërsa në listën e bursave që kanë tepruar jashtë vendit, nga 2 përfitues gjithsej, aplikuesja është renditur në listë nr 3, sipas notës mesatare dhe kriterëve tjerë të përcaktuara në konkurs.
12. Erza Zabërgja, studente e Mjekësisë së përgjithshme, i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0016366/25, Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025. Me A r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë brenda kategorisë ku ka aplikuar. Ndërsa në listën e bursave që kanë

tepruar jashtë vendit, nga 2 përfitues gjithsej, aplikuesja është renditur në listë nr 5, sipas notës mesatare dhe kriterëve tjera të përcaktuara në konkurs.


13. Dea Zabargja studente e Mjekësisë se përgjithshme i REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0016575/25, Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025.Me A r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë brenda kategorisë ku ka aplikuar. Ndërsa në listën e bursave që kanë tepruar jashtë vendit, nga 2 përfitues gjithsej, aplikuesja është renditur në listë nr 4, sipas notës mesatare dhe kriterëve tjera të përcaktuara në konkurs.
14. Pënar Kera studente e shkencave kompjuterike REFUZOHET si e PABAZUAR ankesa nr. 10-104/02-0017285/25. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 289/25 i Komisionit vlerësues, publikuar me datë: 15.04.2025.Me A r s y e t i m. Komisioni i Ankesave ka rishqyrtuar aplikacionin e ankueses, dhe arsyet e mos përfshirjes në listën e përfituesve, ku është konstatuar se e njëjta për shkak të notës mesatare është renditur më poshtë se kundër kandidatet tjerë. Pretendimet tjera të ankueses, se nga lista preliminare ka studentë që janë përfitues të dyfishtë të bursës, në rastin konkret edhe të bursës nga UMIB, nuk qëndron, ngase lista e bashkëngjitur është e përfituesve për vitin akademik 2023/24, ndërsa bursat e ofruara nga Komuna e Vushtrisë janë për vitin akademik 2024/25.

Si përfundim, vlenë të ceket se, pas shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i Ankesave, lista studentëve mbetet e njëjtë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



DATE:	14.07.2025
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
PROPOZUES:	Z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë 
HARTUES:	Znj. Mirjeta Duraku  Kryesuese e Komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028
TEMA	Akt-Përcjellës

Të nderuar,

Komisioni komunal i mandatuar nga Kryetari i Komunës, ka hartuar Draft-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028, konform procedurave të parashikuara me legjislacionin në fuqi dhe të njëjtat i paraqet për shqyrtim dhe aprovimin tuaj.

Këto dokumente janë në fazën e konsultimit publik, dhe presim që deri në mbledhjen e Kuvendit të merren propozimet dhe vërejtjet eventuale nga aktet dhe palët e interesuara.

I propozojmë Komitetit për Politikë dhe Financa që t'i shqyrtojë këto dokumente dhe t'i procedojë për aprovimin e tyre në Kuvend.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

DRAFT-RREGULLORE
PËR TRANSPARËNCË NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

Korrik, 2025

Në mbështetje të neneve 12, pika “d” në lidhje me nenin 68, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28.06.2008), nenit 42 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe nenit 19 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më _____2025 miraton këtë:

RREGULLORE PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, kuvendit të komunës, trupave të kuvendit, drejtorive, mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha organet e komunës që ushtrojnë autorizime publike sipas ligjit.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Transparencë** - Transparenca është veprimtari e hapur e organeve të komunës që siguron publikim, informim, qasje në dokumente publike dhe përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe punës së organeve komunale.

1.2. **Akte normative të komunës** – nënkupton akte normative të karakterit të përgjithshëm të tilla si: Statuti i Komunës, rregulloret e Kuvendit të Komunës, planet hapësinore në nivel lokal, aktet të tjera që parashihen me ligjet sektoriale.

1.3. **Llogaridhënie** – nënkupton procesin ku institucionet komunale japin përgjegjësi për ushtrimin e kompetencave të tyre.

1.4. **Vendim** – nënkupton akt normativ që nxirret nga organi kompetent i komunës sipas dispozitave ligjore me të cilin vendoset për çështje të caktuar.

1.5. **Konsultim publik** – nënkupton përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin konsultues para vendimmarrjes.

1.6. **Buxhetim me pjesëmarrje** - nënkupton një proces demokratik dhe gjithpërfshirës, i cili u mundëson qytetarëve të kenë rol të drejtpërdrejtë vendimmarrës, për të planifikuar shpërndarjen e buxhetit të komunës, sipas prioriteteve të qytetarëve.

1.7. **Dëgjim buxhetor** – nënkupton konsultimet publike të mbajtura nga komunat në procesin e hartimit të buxhetit dhe projeksioneve afatmesme buxhetore.

1.8. **Dokument publik** – nënkupton çdo akt, fakt apo informatë në formë fizike dhe elektronike të shkruar apo me zë, në formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik.

1.9. **Grupi punues** – është ekipi përgjegjës për hartimin e projekt propozimit, i caktuar nga organi kompetent i komunës.

1.10. **Live meeting office communicator apo transmetime direkte në youtube apo rrjetet sociale** – nënkupton aplikacione përmes së cilave mundësohet komunikimi në distancë.

1.11. **Sesion i teleprezencës** - nënkupton akceptimin i e - mailit të dërguar nga komunat për qasje në formatin përkatës.

1.12. **Sistemi operativ MS Windows 7** nënkupton sistem operativ i teknologjisë së Microsoftit.

1.13. **MAPL** – nënkupton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

1.14. **Monitorim i kuvendit të komunës përmes teleprezencës** - nënkupton të drejtën dhe mundësinë e MAPL-së që përmes pajisjeve të teleprezencës të siguroj mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve të komunave pa praninë fizike të zyrtarëve në komunë.

1.15. **Pajisje për transmetim dhe monitorim të mbledhjeve** - nënkupton kamerë e përshtatshëm për teleprezencë që mundëson transmetimin e mbledhjeve me pamje të kompletuar përmes video dhe audio përmbajtjes;

1.16. **Palë e interesuar** – nënkupton çdo person fizik dhe juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit, si dhe subjekte të tjera që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes.

1.17. **Projekt-propozim apo Projekt-akt** - nënkupton të gjitha dokumentet dhe aktet normative të cilat janë në proces të hartimit dhe që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik para aprovimit të tyre.

1.18. **Propozues i akteve nënligjore të komunës dhe politikave lokale** – nënkupton: kryetarin e komunës, drejtoritë komunale, kryesuesin e kuvendit të komunës, komitetet e kuvendit të komunës, pesëmbëdhjetë për qind (15%) e qytetarëve të komunës përkatëse me të drejtë vote.

1.19. **Politika lokale** – i referohet, planeve, dokumenteve strategjike, buxhetit të komunës, Korniza Afatmesme Buxhetore, planeve hapësinore në nivel lokal, akteve komunale,

strategjive të zhvillimit në kuadër të fushave specifike zhvillimore, udhëzuesve dhe veprimeve të cilat ndikojnë në vendimmarrjen komunale, planeve të punës së kuvendit dhe ekzekutivit, si dhe programeve të tjera të rëndësishme me interes publik.

1.20. Pronë komunale - nënkupton pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruar dhe në posedim të komunës.

1.16. Standardet minimale të konsultimit - janë rregulla procedurale minimale që kanë për qëllim zhvillimin e konsultimeve publike efikase gjatë procesit të hartimit të politikave dhe akteve normative nga komunat, me përfshirje të palëve të interesuara dhe qytetarëve, përveç nëse parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi.

1.21. Takim publik me qytetar – nënkupton takime të rregullta publike të karakterit informues me qytetarë sipas nenit 68 parag.1 të Ligjit Nr.03L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

1.22. Zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike - nënkupton zyrtar administrativ në kuadër të institucionit publik, i caktuar për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuarra për qasje në dokumente publike, për kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, për ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe për raportimin rreth këtyre kërkesave.

1.23. Zyrtari për Monitorim - nënkupton zyrtarin përgjegjës për monitorim të komunave në MAPL.

2. Shprehjet e përdorura në shumës e kanë të njëjtin kuptim edhe në njëjës, dhe shprehjet e përdorura në një gjini e kanë kuptimin e njëjtë edhe për gjininë tjetër.

KAPITULLI II

TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 4

Transparenca në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve

1. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve janë publike, përveç rasteve kur kufizimi është përcaktuar me ligj.
2. Kryesuesi i Kuvendit ose kryesuesi i komitetit, përmes shërbimit të administratës ofron kushtet, mjetet, materialet dhe vendin e caktuar për të garantuar pjesëmarrjen e publikut.
3. Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Njesisë për Komunikim Publik obligohet të publikoj në ueb faqen zyrtare të gjitha aktet dhe vendimet e Kuvendit dhe trupave të tjera.

Neni 5

Informimi për mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve

1. Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Njesisë për Komunikim me Publikun, publikon njoftimin për mbledhje së paku 7 (shtatë) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, 3 (tre) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës për mbledhjet urgjente.

2. Njoftimi për mbledhje nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet përmes:

2.1. Ueb-faqes zyrtare të komunës dhe tabelat e shpalljeve.

2.2. Me qëllim të arritjes së audiencës komuna promovon agjendën në rrjete sociale, dhe forma alternative të komunikimit me publikun.

3. Njoftimi publik sipas paragrafit 2 të këtij neni përmban:

3.1. Datën, kohën vendin, rendin e ditës, materialet e mbledhjes për mbajtje të takimit.

3.2. Komuna publikon edhe të dhëna të tjera të cilat përcaktohen me Statut dhe Rregullore të Punës së Komunës.

4. Kryesuesi i Kuvendit me shkresë zyrtare me informacionet sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni e njofton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për mbledhjen e kuvendit.

5. Komuna përveç informimit për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve vazhdimisht duhet ti njoftojë që qytetarët kanë të drejtë të jenë pjesë e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Monitorimit elektronik i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave

1. Organet e Komunës janë të obliguara të sigurojnë qasje aktive në përdorimin e sistemit të teleprezencës, me qëllim të krijimit të kushteve për monitorim dhe vlerësim të proceseve për mekanizmat monitoruese të MAPL-së, palëve të interesuara dhe institucioneve tjera në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, përmes stafit të autorizuar të komunës.

2. Komuna mund të përdorë aplikacione si live meeting office communicator apo transmetime direkte në you-tube apo rrjetet sociale për të garantuar publicitet, si dhe çfarëdo platforme të ligjshme për të transmetuar drejtpërdrejtë ngjarjen.

3. Kryesuesi, anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryetari, dhe pjesëmarrësit e tjerë janë të obliguar që gjatë rrjedhës së punimeve të Kuvendit të përdorin mikrofonin i cili mundëson lidhjen me sistemin e zërimit dhe transmetimin e audio – përmbajtjes në sistem.

Neni 7

Përdorimi dhe mirëmbajtja e sistemit të Teleprezencës

1. Komuna është e obliguar të sigurojë kushtet për funksionimin e teleprezencës gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

2. Sekretaria e Kuvendit të Komunës është përgjegjëse për menaxhimin e llogarisë së formës vc.komuna@rks-gov.net, gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

3. Zyrtari përgjegjës për monitorim të komunave ka të drejtën e qasjes në sistem në çdo kohë kur mbahen mbledhjet e Kuvendeve të Komunave.

4. Komuna është e obliguar të caktoj një pikë kontaktuese për komunikim me Zyrtarin Monitorues të Ministrisë.
5. Zyrtari përgjegjës i komunës duhet të vendos lidhjen e teleprezencës, 15 minuta para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, përmes pranimit të e-mailit ose linjave të tjera zyrtare nga Zyrtari Monitorues i Ministrisë.
6. Në vendin e mbajtjes së mbledhjes, organet e komunës duhet të sigurojnë prezencën dhe funksionimin e pajisjeve të teleprezencës.
7. Zyrtari përgjegjës për informim në Komunë dhe zyra e IT-së obligohen të sigurojnë lidhjen e transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjes së Kuvendit të Komunës në sistemin e integruar të faqes zyrtare të Komunës, për t'i mundësuar qasjen qytetarëve dhe palëve të interesuara për përcjelljen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës.
8. Sekretaria e Kuvendit të Komunës dhe zyra e IT-së obligohen të arkivojnë videot dhe audiot nga mbledhjet e mbajtura të Kuvendeve të Komunave në arkivën elektronike të komunës.
9. Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës janë përgjegjës për të siguruar kushtet për Monitorimin elektronik të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave.

Neni 8

Njoftimi për mbledhjet e Kuvendeve të Komunave për monitorim elektronik

1. Komuna obligohet të dërgoj në Ministri ftesën dhe materialet shtesë të mbledhjes së Kuvendit në formë elektronike të paktën shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të rregullta, si dhe tri (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme.
2. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, rendin e ditës, kohën e saktë të mbledhjes, materialet e mbledhjes, ashtu siç është paracaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 9

Kufizimi i qasjes në mbledhjet e kuvendit apo komitetit

1. Mbledhjet e Kuvendit apo komiteve mund të jenë të mbyllura pjesërisht apo tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara me legjislacionin në fuqi.
2. Kuvendi i Komunës dhe komitetet e kuvendit me vendim të arsyetuar shpallin mbledhjet plotësisht apo pjesërisht të mbyllura për publikun.

KAPITULLI III TRANSPARENCA E EKZEKUTIVIT

Neni 10 Transparenca e ekzekutivit

1. Kryetari i komunës ofron transparencë për procesin vendimmarrës të tij, drejtorive dhe administratës.
2. Kryetari i komunës është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në publikim të akteve të ekzekutivit, dhe dokumenteve zyrtare në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente Publike.
3. Kryetari i komunës raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës.
4. Kryetari i komunës me vendim të veçantë ka të drejtë të përcaktoj rregullat e hapjes dhe menaxhimit të rrjeteve sociale, si dhe platformave të transmetimit.

KAPITULLI IV PUBLIKIMI I AKTEVE, DOKUMENTEVE ZYRTARE DHE FINANCIARE DHE AKTEVE TË TJERA TË KUVENDIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT

Neni 11 Publikimi i Akteve të Komunës

1. Komuna publikon të gjitha aktet e aprovuara nga kuvendi i komunës në ueb-faqen zyrtare pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim.
2. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare vendimet, urdhëresat e nxjerra nga kryetari i komunës.
3. Aktet dhe dokumentet e nxjerra nga drejtorit e komunës duhet të publikohen me qëllim të rritjes së transparencës.
4. Aktet dhe dokumentet e nxjerra nga paragrafi 1, 2 dhe 3 duhet të publikohen duke respektuar legjislacionin në fuqi përfshirë Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-81 për qasje në dokumente Publike.
5. Aktet dhe dokumentet nga parag.1, 2 dhe 3 të këtij neni publikohen nga njësia përgjegjëse për komunikim në komunë, në formë elektronike, në pajtim me dispozitat e legjislacionin Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
6. Komuna mund të shfrytëzoj edhe platforma të tjera për të publikuar aktet dhe dokumentet e nxjerra veçanërisht ato me karakter informues dhe vetëdijuese.

Neni 12

Publikimi i dokumenteve zyrtare

1. Komuna obligohet të publikoj të gjitha dokumentet zyrtare, përfshirë por duke mos u kufizuar në:

1.1. Planin vjetor të punës së Kryetarit dhe drejtorive;

1.2. Planin Vjetor të punës së Kuvendit të Komunës;

1.3. Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave;

1.4. Planet hapësinore komunale: Planin Zhvillimor të Komunës, Hartat Zonale, Planet Rregulluese të Hollësishme;

1.5. Raportet periodike zyrtare të Kuvendit dhe Ekzekutivit;

1.6. Dokumentet e prodhuara nga Kuvendi i Komunës përfshirë procesverbalet e takimeve të kuvendit të komunës, komiteteve obligative, komiteteve të tjera konsultative, si dhe materialet e tjera publike të prodhuara nga Kuvendi i Komunës.

1.7. Të gjitha dokumentet e prodhuara gjatë proceseve të thirrjeve publike si grante, subvencione, konkurse publike, ankande, si dhe dokumente të tjera.

1.8. Video-incizimet e mbledhjeve të kuvendeve të komunës dhe materialet tjera të teleprezencës me linqet përcjellëse.

1.9. Komuna obligohet që dokumentet e kërkuara sipas dispozitave të kësaj Rregullore, t'i publikoj në formatin që ofron mundësinë e përpunimit të përmbajtjes. Përveç në rastet e kërkuara me ligj dokumentet nuk do publikohen në formatin PDF Scan.

Neni 13

Publikimi i dokumenteve financiare

1. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare të saj dokumentet financiare si vijon por nuk kufizohet në:

1.1. Buxhetin vjetor të Komunës;

1.2. Listën e projekteve kapitale;

1.3. Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB);

1.4. Raportet financiare vjetore dhe tremujore siç parashihen me legjislacionin sektorial për financat publike;

1.5. Raportet vjetore të punës së kuvendit dhe ekzekutivit;

1.6. Raportin e zyrës kombëtare të auditimit dhe rekomandimet përcjellëse;

1.7. Çdo dokument tjetër financiar të kërkuar me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 14 **Transparenca e aktiviteteve të prokurimit**

1. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial, përfshirë por duke mos u kufizuar në:

1.1 Planin e prokurimit,

1.2. Raportin e prokurimit,

1.3. Njoftimet paraprake; Njoftimet për kontratë; Njoftimet për dhënie të kontratës, Njoftimet për konkurs të projektimit; Njoftim për rezultatet e konkursit të projektimit; Njoftim për anulim; Njoftim për informata shtesë; Anulim të dhënies së kontratës; Njoftim për nënshkrimin e kontratës; Ankandet Publike; Vendimet e Komunës ndaj kërkesave për rishqyrtim; Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit,

1.4. Vendimet, dokumentet dhe të dhënat e tjera të nevojshme të përcaktuar me legjislacionin sektorial dhe në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente Publike.

2. Për çdo projekt, komuna vendos pano informuese për aktivitetin e prokurimit, në të cilin shkruhet emri i projektit, investitori, kompania implementuese dhe kohëzgjatja.

3. Me qëllim të rritjes së transparencës komuna do vendosë emrin dhe mbiemrin dhe kontaktet për menaxherin, mbikëqyrësin apo kompaninë mbikëqyrëse të projektit.

Neni 15 **Transparenca në menaxhimin e pronës komunale**

1. Komuna duhet të garantoj proces transparent në procedurat dhe dokumentet e hartuara gjatë menaxhimit të pronës komunale bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi.

2. Komuna publikon listën e pronave komunale, pronave të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim, pronave të dhëna në shfrytëzim dhe aseteve të tjera të rëndësishme të komunës.

3. Të dhënat që do të publikohen përfshijnë por nuk kufizohen në të dhëna për njësi kadastrale, zona kadastrale vendi i pronës dhe qëllimi.

4. Publikimi i listës sipas legjislacionit në fuqi duhet të përmbyllet deri me 31 dhjetor të vitit kalendarik.

5. Proceset e ankandit, shprehjes së interesit, dhënies në shfrytëzim, këmbimit dhe procedurat tjera të tjetërsimit të pronës komunale janë publike.

6. Për çështje të interesit publik informacione mbi menaxhimin e pronës së luajtshme dhe aseteve të tjera të komunës do jenë publike.

Neni 16

Transparenca e ndërmarrjeve publike

1. Komuna kujdeset të siguroj kushtet për procese transparente gjatë ushtrimit të funksionit të vet në menaxhimin dhe realizimin e funksioneve të ndërmarrjeve komunale dhe përfaqësimit në ndërmarrjet rajonale.
2. Në rastet ku shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet komunale, ato ndërmarrje duhet t'ia dorëzojnë buxhetet e tyre kuvendit të komunës për miratim. Propozimet buxhetore duhet të përfshijnë strukturën e propozuar të tarifës për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohen para datës 15 nëntor të vitit të ardhshëm fiskal.
3. Raportet të cilat do i dorëzohen kuvendit të komunës do të jenë publike në ueb faqen zyrtare të komunës.
4. Me qëllim të rritjes së transparencës raporte të mbikëqyrjes dhe të auditimit të punës së ndërmarrjeve do të i ofrohen publikut.
5. Aktet nënligjore dhe dokumentet tjera zyrtare të hartuara nga ndërmarrjet publike komunale duhet të jenë publike dhe lehtë të qasshme për publikun në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente Publike.

KAPITULLI V

FORMAT E PËRFSHIRJES AKTIVE TË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Neni 17

Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë

1. Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e:
 - 1.1 Takimeve publike;
 - 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave;
 - 1.3 Takime konsultative me qytetarë;
 - 1.4 Dëgjime buxhetore.
2. Trajtimin e kërkesave peticioneve dhe kërkesave individuale e grupore të qytetarëve.
3. Me qëllim të marrjes së pikëpamjeve të qytetarëve në procesin vendimmarrës, komuna siguron zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik të përcaktuara në këtë Rregullore.
4. Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale.

5. Ueb faqja e komunës dhe platforma qeveritare për konsultime publike do përdoren si platforma për realizimin e qëllimeve të këtij neni.

6. Zyra për Komunikim me Publikun, është përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve për vendin, datën, kohën, vendin, rendin e ditës, se kur do të mbahen takimet, dëgjimet buxhetore, konsultimet publike dhe takime tjera shtesë.

Neni 18

Takimet publike

1. Çdo vit komuna mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. Takimi i parë obligativ mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa takimi i dytë në gjashtëmujorin e dytë.

2. Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës.

3. Komuna mundet të organizojë edhe takime shtesë, dhe të jetë sa më pranë qytetarëve për çështje që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm.

4. Njoftimi për takime publike duhet të publikohen dy javë para mbajtës së takimit.

5. Njoftimi për takime publike duhet bëhet përmes:

5.1 Ueb-faqes zyrtare të komunës dhe hapësirat publike në komuna;

5.2 Me qëllim të arritjes së audiencës komuna promovon agjendën në rrjete sociale, dhe forma alternative të komunikimit me publikun.

6. Zyra për Komunikim me Publikun në komuna është përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve për vendin, datën, kohën kur do të mbahen takimet dhe materialet.

7. Komuna siguron hapësirat e mjaftueshme brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.

8. Në takimet publike marrin pjesë zyrtarët e lartë të komunës, si: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive përkatëse, Kryesuesit e komiteteve dhe Zyrtarët kompetent për çështje në takimin publik.

9. Mekanizmat përfaqësues të komunitetit të themeluar sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunim e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet publike, duhet të jenë të njoftuar zyrtarisht për takimet.

10. Nëse gjatë takimit qytetarët dhe palët e interesit nuk kanë marrë përgjigje në pyetjet e parashtruara, komuna obligohet që në raport brenda 30 ditësh të ofroj përgjigje me shkrim. Në procesverbal konstatohet që përgjigja do të ofrohet me shkrim duke e përcaktuar zyrtarin përgjegjës dhe hapësirën ku do të publikohet përgjigja.

11. Në kuadër të kompetencave të tyre drejtorët e drejtorive mbajnë takime informuese me grupe të tjera përfaqësuese si shoqata, sindikata, këshilla grupe të interesit dhe qytetarë me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje. Takimet e kësaj natyre janë publike dhe për të njëjtat do të respektohet paragrafi. 4 dhe 5 e këtij neni.

Neni 19

Konsultimet publike

1. Organet përgjegjëse të komunës duhet të sigurojnë zbatimin e procesit të konsultimit publik, gjatë hartimit të politikave dhe akteve nënligjore të komunës për të cilat konsultimi publik është i obligueshëm.
2. Komuna siguron ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme që të siguroj një partneritet aktiv në mes palëve të ndryshme gjatë procesit të konsultimit publik.
3. Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin; Ligjshmërisë, Transparencës, Barazisë, Mosdiskriminimit dhe Efikasitetit në procesin e konsultimit publik.

Neni 20

Planifikimi i konsultimeve publike

1. Planifikimi i përgjithshëm i konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik, si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim me publikun.
2. Zyrtari përgjegjës për konsultim publik në koordinim me iniciuesit harton plan të veçantë, për të gjitha projekt propozimet e organit propozues të akteve nënligjore dhe politikave lokale, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik për vitin e ardhshëm kalendarik.
3. Plani i konsultimeve publike duhet të jetë pjesë përbërëse e planit për komunikim me publikun dhe duhet të publikohet.
4. Planifikimi i konsultimit merr për bazë afatet kohore, kostot financiare, resurset njerëzore, identifikimin e palëve të përfshira në procesin e konsultimit publik, si dhe format dhe teknikat e konsultimit publik.

Neni 21

Fazat e Konsultimit Publik

1. Procesi i konsultimit publik në komunë ndahet në tri faza:
 - 1.1. Planifikimi i konsultimeve;
 - 1.2. Mbajtja e konsultimeve;
 - 1.3. Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre në organet përgjegjëse.

Neni 22

Aktet obligative për konsultime publik

1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:

- 1.1 Draft-Statuti i komunës,
 - 1.2. Projekt-Rregulloret komunale,
Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komunë ka përcaktuar buxhetimin me pjesëmarrje si një instrument të cilin komunitat mund të shfrytëzojnë për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, dhe për të avancuar transparençën e procesit të buxhetimit.

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikën e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

Objektivat e Planit të Veprimit për transparencë

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është *“të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse”*.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgjohen dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i hartimit të politikave është baza e informacionit.
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

Fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale

Zhvillimi i Model – Planit të veprimit për transparencë përbëhet prej disa faza si në vijim:

- 1) **Faza Paraprake** – Kryetari i komunës themelon grupin e punues. Përbërja e grupit punues duhet të jetë shumësektoriale dhe të udhëhiqet nga Zyra për Komunikim Publik në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.
- 2) **Faza e vlerësimit të prioriteteve** – gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionet e mbledhura (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; dokumentet strategjike të komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate, duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.

- 3) ***Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave*** – kjo fazë përfshin kategorizimin e prioriteteve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.
- 4) ***Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë*** - përfshin monitorimin, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të veprimit për transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioriteteve, duke mundësuar që komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit: 1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës; Llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve; Fushëveprimit të akteve juridike të planifikuara për hartim; Ndikimit të tyre ekonomik dhe social; Peshës financiare të politikës së propozuar; Periudhës kohore të veprimit; Shtrirjes gjeografike; etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve, grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit si pjesë përbërëse të planit të veprimit, që janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

Monitorimit i zbatimit të Planit të transparencës

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politikbërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të planit të veprimit për transparencë, krijohet mekanizmi për monitorimin dhe raportimin për këtë plani, si në vijim:

Grupi punues - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh sigures i zbatimit të planit dhe garanton që në baza periodike Plani Vjetor i Punës së Komunës të ndërlidhet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Monitoron zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e planit të veprimit për transparencë;

Plani i Veprimit për Transparencë Komunale

Objektivat	Aktivitetet	Treguesit e matjes	Afati kohor	Njësia/personi përgjegjës	Mënyra e njoftimit / zbatimit	Dokumentet referuese	Kolonë raporti mi
Transparenca e Kuvendit të Komunës							
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve	Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të nevojshme, hapësirës për pjesëmarrjen publikut dhe përfaqësuesit e mediave të shkruara/elektroni ke në takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve	1) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të kuvendit në ueb faqe zyrtare të komunës, kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të komunës, apo format e tjera të informimit. 2) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të komiteteve në ueb faqe zyrtare të komunës, kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të komunës, apo format e tjera të informimit.	1) Njoftimi shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta Kuvendit; 2) Njoftimi 3 ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme; 3) Thirrja brenda ditës për mbledhje urgjente	Kryesuesi i kuvendit të Komunës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për Informim	Përmes ueb-faqes zyrtare; Shpalljeve publike; Rrjete sociale; Formave të tjera të informimit.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna - Statuti i Komunës; - Rregullorja komunale për transparencë	
	Transmetimi në kohë reale i mbledhjeve të kuvendit të komunës	Numri i mbledhjeve të kuvendit të transmetuara drejtpërdrejtë.	Në vazhdimësi	Sekretaria e kuvendit; Zyrtari i IT-së;	Përmes ueb-faqes zyrtare; E-komunat;	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;	

				Zyra për Informim	Youtube; Mediave lokale;	- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna; - Statuti i Komunës; -Rregullorja komunale për transparencë.	
	Publikimi i akteve të kuvendit të komunës pas plotësimit të kushteve ligjore (Statutit, Rregulloreve, Vendimeve)	1) Numri i akteve të aprovuara; 2) Numri i akteve të publikuara në gjuhët zyrtare	Pas afatit 15 ditor të vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për qeverisje lokale	Kryesuesi i kuvendit Sekretaria e kuvendit Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës Udhëzimi Administrativ	

						(MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës	Plani i publikuar në gjuhët zyrtare në ueb- faqen zyrtare të komunës	Fillimi i muajit Janar	Sekretaria e kuvendit Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i Strategjive dhe dokumentet e tjera të politikave të kuvendit të komunës;	1. Numri i strategjive dhe dokumenteve të politikave i aprovuar; 2. Numri i Strategjive dhe dokumente të politikave, i publikuar	Pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim	Sekretaria e Kuvendit në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse për hartimin e dokumentev e dhe Zyrën për Informim	Ueb-faqja e komunës; Platforma të tjera.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i Planeve hapësinore komunale: Planin Zhvillimor të Komunës, Hartat Zonale, Planet	1. Numri i Planeve të aprovuara; 2. Numri i Planeve të publikuara	Pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim	Drejtoritë përkatëse në bashkëpunim me Zyrën për Informim	Ueb-faqja e komunës; Platforma të tjera.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë	

	Rregulluese të Hollësishme;					të hapur në komuna	
	Ofrimi i qasjes së drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike	Informatat dhe dokumentet zyrtare të publikuara në ueb-faqen e komunës	Në vazhdimësi	Zyra për Informim Njësitë organizative Sekretaria e Kuvendit Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i raporteve të punës së kuvendit të komunës	Raporti vjetor i publikuar në gjuhët zyrtare	Deri më 31 janar për vitin paraprak	Sekretaria e Kuvendit; Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës; Platforma të tjera sociale.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i dokumenteve të prodhuara nga Kuvendi i Komunës përfshirë	1. Numri i dokumenteve të hartuara; 2. Numri i dokumenteve të	Pas aprovimit të dokumenteve në mbledhjet e radhës	Sekretaria e Kuvendit; Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë	

	procesverbalet e takimeve të kuvendit të komunës, komiteteve obligative, komiteteve të tjera konsultative, si dhe materialet e tjera publike të prodhuara nga Kuvendi i Komunës.	publikuara brenda afateve ligjore.				të hapur në komuna	
	Publikimi i Video-incizimeve të mbledhjeve të kuvendeve të komunës dhe materialet tjera të teleprezencës me linqet përcjellëse	1. Numri i video-materialeve të incizuara; 2. Numri i video-materialeve, i publikuar	Pas mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit	Sekretaria e Kuvendit; Zyra e IT-së Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i profileve të anëtarëve të kuvendeve të komunave	Biografite e anëtarëve të kuvendit dhe të dhënat kontaktuese të publikuara;	Me rastin e marrjes së mandatit;	Sekretaria e Kuvendit; Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike	
	Publikimi i të dhënave për përbërjen e komiteteve të	1) Të dhënat e përfaqësuesve në komitete të publikuara;	Sipas kohës së themelimit dhe funksionalizimit;	Sekretaria e Kuvendit;	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023	

	kuvendit dhe funksioneve të tyre	2) Vendimet për themelimin e komiteteve të publikuara; 3) Përgjegjësitë e komiteteve të përshkruara në ueb-faqe.		Zyra për Informim		për Administratë të hapur në komuna Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike	
Transparenca e Kryetarit të Komunës / Përfshirja e qytetarëve/ Qasja në dokumentet publike / Informimi publik							
Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së kryetarit/e kzekutivit	Publikimi i profileve të kryetarit dhe drejtorëve të emëruar të drejtorive	Biografite dhe kontaktet e publikuara	Me rastin e marrjes së mandatit;	Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike	
	Publikimi i informatave kryesore dhe të shërbimeve për secilën njësi organizative të komunës	Të dhënat për shërbime dhe kontaktet e publikuara	Në vazhdimësi	Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike	

	Publikimi i akteve të kryetarit të komunës (vendimeve dhe urdhëresave)	1. Numri i akteve të aprovuara; 2. Numri i akteve të publikuara	Publikimi pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim	Zyra e Kryetarit Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës Komuna mund të shfrytëzoj edhe platforma të tjera për të publikuar aktet dhe dokumentet e nxjerra veçanërisht ato me karakter informues dhe vetëdijuese.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i akteve të drejtorive të komunës	1. Numri i akteve të aprovuara; 2. Numri i akteve të publikuara.	Publikim pas plotësimit të kushteve ligjore	Drejtoria përkatëse Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës Komuna mund të shfrytëzoj edhe platforma të tjera për të publikuar aktet dhe dokumentet e nxjerra	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

					veçanërisht ato me karakter informues dhe vetëdijuese.		
	Publikimi i Planit vjetor të punës së Kryetarit dhe drejtorive;	Plani i publikuar	Pas aprovimit	Zyra e kryetarit Njësitë përkatëse Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i Strategjive dhe dokumentet e politikave të hartuara dhe aprovuara nga ekzekutivi;	1. Numri i strategjive, dokumente të aprovuara 2. Numri i strategjive, dokumente të publikuara	Pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim	Zyra e kryetarit Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Diskutimi i raportit të kryetarit në kuvendin e komunës	Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës	Njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës	Kryetari i komunës; Ekzekutivi;	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;	

	Dorëzimi i raporteve tremujore financiare në kuvendin e komunës dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare	2) Raportet e publikuara në ueb-faqe	1) Tremujori 1 para datës 30 Prill; 2) Tremujori 2 para datës 31 Korrik; 3) Tremujori 3 para datës 31 Tetor	Kryetari i komunës; Ekzekutivi; Zyra për Informim	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna;	
--	---	---	--	--	---	---	--

	Publikimi i raportit përfundimtar financiar	Raporti i publikuar	Jo më vonë se me 31 mars të çdo viti kalendarik	Kryetari i komunës; Ekzekutivi; Zyra për Informim.	Ueb-faqja zyrtare e komunës	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i Raportit të zyrës kombëtare të auditimit dhe rekomandimet përcjellëse	1. Raporti i publikuar; 2. Plani i veprimit për përmbushjen e rekomandimeve të auditorit i publikuar.	Pas publikimit nga ZKA	Zyra e Kryetarit Zyra për Informim	Ueb-faqja zyrtare e komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

	Diskutimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kuvendin e Komunës	Raporti i inkorporuar në rend të ditës dhe i diskutuar në KK	Pas publikimit nga ZKA	Kryesuesi i kuvendit Kryetari i komunës Zyra për Informim	Inkorporomi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
Transparencë buxhetore dhe në procedurat e prokurimit publik	Publikimi i KAB dhe buxhetit vjetor.	KAB dhe Buxheti vjetor të publikuara.	Pas miratimit nga Kuvendin e Komunës.	Zyra e Kryetarit Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Thesar Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës; Promovimi në platforma të tjera.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

	Publikimi i listës së projekteve kapitale;	Lista e publikuar	Pas aprovimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës	Drejtoria përkatëse Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës; Promovimi në platforma të tjera	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i listës së subjekteve përfituese nga kategoria e subvencioneve	Lista e përfituesve të subvencioneve, e publikuar.	Pas miratimit të listës nga ana komisionit vlerësues	Drejtoria përkatëse Zyra për Informim	Ueb-faqja zyrtare e komunës; platformat e tjera sociale.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

	Plani prokurimit për vitin fiskal i aprovuar	Publikimi i Planit të prokurimit i publikuar në ueb-faqe	Pas miratimit dhe shpalljes së ligjit vjetor për ndarjet buxhetore	Zyra për prokurim Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi	Legjislacioni i prokurimit në fuqi Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të planit për prokurim publik	Raporti i prokurimit i publikuar	Jo me vone se 31 janar, për vitin paraprak	Zyra e prokurimit bashkëpunim me Zyrën për Informim	Ueb-faqja e komunës	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimit Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023	

						për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i të gjitha aktiviteteve të prokurimit në ueb-faqen e komunës	Numri i aktiviteteve të prokurimit të publikuara në	Në vazhdimësi	Zyra e prokurimit bashkëpunim me Zyrën për Informim	Ueb-faqja e komunës; E- prokurimi	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimit Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MAPL)	

						Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i vendimeve dhe të dhënave të tjera të nevojshme të zyrtarëve komunal të autorizuar për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura me operatorët ekonomik të kontraktuar, procesverbalet. Publikimi bëhet në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit per Mbrojtjen e të Dhënave Personale	1. Numri i zyrtarëve të autorizuar për monitorim sipas vendimeve dhe publikimi i tyre;	Në vazhdimësi.	Zyra e prokurimit bashkëpunimi me Zyrën për Informim	Ueb-faqja e komunës; E- prokurimi	Ligji i Prokurimit Publik Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

Transparenc a në menaxhimin e pronës komunale	Publikimi i listës së pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin fijues	Lista e pronave, e publikuar	Deri me 31 dhjetor.	Sekretaria e kuvendit Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Zyra për Informim	Ueb-faqja Platforma të tjera	Ligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i proceseve të ankandit, shprehjes së interesit, negocimit, dhënies në shfrytëzim, këmbimit dhe procedurat tjera të tjetërsimit pronës komunale janë publike.	Proceset e zhvilluara, të publikuara	Në vazhdimësi.	Sekretaria e kuvendit Zyra e kryetarit Zyra për Informim	Ueb-faqja Platforma të tjera	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
Takimet publike dhe konsultimi me qytetarë gjatë	Mbajtja e se paku dy takimeve publike me qytetare brenda vitit	2 takime të mbajtura gjatë vitit	Takimi i parë në gjashtëmuajorin e parë të vitit;	Zyra e Kryetarit Zyra për Informim	Njoftimi përmes ueb- faqes së komunës;	Ligji Nr. 03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale;	

procesit të hartimit të politikave			Takimi i dytë në gjashtëmuorin e dytë të vitit.		Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit, mjeteve të informimit; Rrjeteve sociale; Takime të drejtpërdrejta;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e takimeve me qytetarë për tema specifike	Numri i takimeve të mbajtura	Së paku 8 ditë para takimit.	Zyra për Informim	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit, mjeteve të informimit; Rrjeteve sociale;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

					Takime të drejtpërdrejta;		
	Konsultimet publike për projektakte dhe dokumente të politikave	1. Plani i veçantë i konsultimit për projekt propozimet i përfshirë në planin për komunikim me publikun dhe i publikuar. 2. Publikimi i projekt propozimeve për të cilat kërkohet konsultim publik, të aprovuara; 3. Publikimi i takimeve/konsultimeve të mbajtura me qytetarë 4. Publikimi i projekt propozimeve për të cilat është zhvilluar konsultimi me shkrim/formë elektronike në ueb-faqe të komunes/platëformën e konsultimeve publike	Deri me 31 janar të vitit. 8 deri në 14 ditë kalendarike para takimit. Konsultim zgjatë jo më pak se 15 ditë kalendarike dhe jo më shumë se 30 ditë kalendarike	Kryetari/Dr e jtoritë/Gru pet Punuese për hartimin e projektakteve/projektpropozimeve Sekretaria e Kuvendit Zyra për Informim	Njoftimi bëhet përmes ueb-faqes, platformave të tjera, rrjeteve sociale, mjeteve të informimit; Metodat e zbatimit behet ne pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

		5. Numri i raporteve të konsultimit publik për projektpropozimet e vendosura në konsultim publik	Raporti publikohet brenda 5 ditëve kalendarike pas përfundimit të raportit				
	Mbajtja e dëgjimeve me qytetare për projektbuxhetin e komunës	Dëgjime publike për projektbuxhet, të mbajtura	Së paku 2 (dy) javë para takimit	Kryetari i komunës/Dr ektoritë; Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore; Zyrtari përgjegjës për konsultime publike; Zyra për Informim	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim; Konsultimet elektronike; Publikimi në Platformën	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

				Zyrtari kryesor i financave.	qeveritare për konsultime publike;		
	Mbajtja e dëgjimeve me qytetare për Kornizën Afatmesme Buxhetore	Numri i dëgjimeve me qytetarët për KAB	Para datës 30 qershor të atij viti fiskal	Kryetari i komunës; Drejtoritë.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejt a; Konsultimet me shkrim; Konsultimet elektronike; Platforma qeveritare për konsultime publike;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

	Mbledhja/shqyrtimi i komenteve/propozimeve gjatë procesit të konsultimit publik dhe përgatitja raportit për rezultatet e konsultimit publik të KAB dhe projektbuxhetit	1. Publikimi i konsultimeve publike të mbajtura për KAB-in dhe projektbuxhetin; 2. Publikimi i raportit të konsultimit për KAB-in dhe projektbuxhetin	Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim.	Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt-propozimit; Zyra për Informim	Publikimi në ueb-faqen e komunës dhe platformën qeveritare të konsultimeve publike.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
Buxhetimi me pjesëmarrje	Zbatimi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje	1. Numri i lokaliteteve të përzgjedhura në buxhetimin me pjesëmarrje 2. Përqindja e buxhetit të ndarë për projekte të propozuara nga komunitetet lokale	Së paku 1% e buxhetit të komunës.	Kryetari, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Ueb-faqja e komunës; Rrjetet sociale zyrtare dhe kanalet e tjera të informimit.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	

		në buxhetimin me pjesëmarrje. 3. Njoftimi për takimet e buxhetimit me pjesëmarrje të publikuara.	Së paku 7 ditë para takimit.				
Kërkesat për informimin, iniciativat qytetare dhe petitionet	Shqyrtimi i kërkesave/iniciativave dhe peticioneve të qytetarëve	1) Numri i kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të parashtruara tek Kryetari; 2) Numri i iniciativave kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të shqyrtuara brenda 60 ditësh; 3) Numri i njoftimeve të publikut brenda 15 ditësh për kërkesat, iniciativat qytetare dhe petitionet e parashtruara	Në vazhdimësi	Kryetari i komunës; Kuvendi i komunës. Zyra për Informim		Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
Garantimi i plotë i të drejtave për	Shqyrtimi i rregullt i kërkesave për qasje në	1) Numri i kërkesave të parashtruara nga palët;	(7) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi,	Zyrtari përgjegjës për qasje në	Pranimi përmes zyrtarit përgjegjës	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike	

qasje në dokumentet publike	dokumente publike	2) Numri i kërkesave të shqyrtuara për të cilat palët kanë marrë përgjigje	apo (14) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi në rastet e përcaktuara me ligj.	dokumentet zyrtare;	për konsultime publike. Shqyrtimi nga organi kompetent;		
	Hartimi i raportit vjetor për qasje në dokumentet publike	Raporti vjetor i hartuar dhe dorëzuar në Agjencinë për informim dhe privatësi; Publikimi raportit vjetor për qasje në dokumentet publike	31 dhjetor të vitit paraprak,	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare;	Ueb-faqja e komunës	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike	
	Regjistri me të dhënat zyrtare përgjegjës për qasje në dokumente publike	Publikuar në ueb-faqe	Vazhdimësi	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare. Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike	

Përmbushja e kriterëve të ueb-faqes zyrtare, lehtësimi i shërbimeve dhe informimi i rregullt për qytetarë lidhur me shërbimet.	Publikimi i shërbimeve të ofruara	Numri i shërbimeve që ofron institucioni për publikun; Numri i procedurave dhe kushteve të përfitimit të tyre dhe afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar të publikuara në gjuhët zyrtare; 3) Lista e hollësishme e shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen, e publikuar në gjuhët zyrtare	Në vazhdimësi	Drejtoria përgjegjëse Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës; Qendra për shërbim të qytetarëve	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
--	--	--	----------------------	---	---	--	--

	Ofrimi i shërbimeve elektronike nga e-Komuna dhe e-Kosova	Informimi dhe ofrimi i shërbimeve të hapura on-line.	Në vazhdimësi	Zyrtari Përgjegjës për E-Komuna	E-Kosova, Web faqja zyrtare, rrjetet sociale dhe kanalet e informimit.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna	
--	---	--	---------------	---------------------------------	--	--	--



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	31845 / 25
Nr. i fq. / Br. st.	-1-
Data: / Datum:	08.07.2025
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Vushtrrisë dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Komuna e Vushtrrisë lëshon këtë:

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028.

Këto dy dokumente do të jenë në konsultim publik nga data 08.07.2025 deri më datën 29.07.2025, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet më datë 15.07.2025, në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim nga ora 11:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më datën 29.07.2025, në email adresën mirjeta.duraku@rks-gov.net

Për më shumë detaje në lidhje me Draft-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028, mund të vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqja zyrtare: <https://vushtri.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Platforma e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net>

Facebook: <https://www.facebook.com/KomunaVushtri>

Mirjeta Duraku

Zyrtare për Informim

Duraku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 34214/25

Nr. i fq. / Br. st. /

Data: / Datum: 17.07.2025

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn-Municipality of Vushtri



**Procesverbali nga konsultimi publik për Draft-Rregulloren për
Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për
Transparencë Komunale 2025-2028**

Korrik 2025

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028.

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Ora: 11:00

Data: 15.07.2025

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin anëtarët e komisionit për hartimin e këtyre dy dokumenteve, Mirjeta Duraku, zyrtare për Informim, Bastri Duraku, nga Sekretaria e Kuvendit dhe Islam Latifi, koordinator për Performancë Komunale.

Mirjeta Duraku, kryesuese e komisionit, hapi konsultimin publik me qytetarë dhe i njoftoi se në tavolinat e tyre janë shpërndarë dy dokumentet që do të diskutohen në konsultimin publik.

Më pas, kryesuesja e komisionit para të pranishmëve prezantoi Draft-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028.

Kryesuesja e komisionit tha se pasi që Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal ka miratuar udhëzimin administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, ka filluar puna për hartimin e këtyre dy dokumenteve. Për të arritur deri tek këto dy drafte, MAPL bashkë me Kolegjin e Zyrtarëve për Informim në nivel vendi ka mbajtur disa punëtori, me qëllim që këto dy dokumente të jenë unike për të gjitha komunat. Më pas, është formuar komisioni komunal nga ana e kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, që këto dy dokumente të shqyrtohen dhe të ndiqen procedurat për miratim.

Draft-Rregullorja për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit, drejtorive, mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Paralelisht me hartimin e Rregullores është hartuar edhe Draft-Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028, ku përmes tij synojmë të kontribuojmë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse.

Në këtë Draft-Plan parashihet publikimi i dokumenteve të ndryshme, afati kohor se kur duhet të publikohet, njësia apo personi përgjegjës për publikim të dokumentit dhe mënyra e njoftimit.

Në fillim të këtij Draft-Plani është transparenca e Kuvendit të Komunës, më pas transparenca e kryetarit të Komunës, përfshirja qytetarëve, qasja në dokumente publike dhe informimi publik.

Më pas, fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës për të dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre për këto dy dokumente.

Remzije Zekolli, zyrtare në Komunën e Vushtrrisë, tha se e kam përcjell Rregulloren dhe Planin e Veprimit përmes webfaqes, në fillim dua ta përgëzoj komisionin për një punë të cilën e kanë bërë për hartimin e këtyre dy dokumenteve. Natyrisht se risia është shumë e mirëseardhur dhe ka sjell sukses buxhetimi me pjesëmarrje, ku mënyra se si komuniteti voton për projektin që ata e konsiderojnë se është më i domosdoshmi për ta dhe më funksional për atë komunitet është shumë i mirëseardhur. Mirëpo, kërkoj që gjatë organizimit të buxhetimit me pjesëmarrje përveç në lokalitete, të jetë edhe buxhetimi me pjesëmarrje për gratë e Komunës së Vushtrrisë, ku të jenë pikërisht gratë ato që vendosin se për çfarë projektësh kanë ato nevojë.

Hamëz Makiqi, nga shoqëria civile, e kisha dhënë si koment apo sugjerim këtë pjesën tek buxhetimi me pjesëmarrje, më të vërtetë ju përgëzoj për punën që e keni bërë për arsye se nga pjesëmarrja e qytetarëve në dy lokalitete ka rezultuar të jetë një përvojë dhe një praktikë shumë e mirë, duke u realizuar edhe zotimet nga ana e kryetarit në një proces vendimmarrës të qytetarëve. Çka kisha dashtë tjetër është që të vazhdojë kjo procedurë ose ky mekanizëm që të aplikohet edhe në disa lokalitete të tjera dhe të fuqizohet më shumë pjesëmarrja e qytetarëve.

Besarta Jashari, studente, tha se është bërë një punë shumë e mirë për hartimin e këtyre dy dokumenteve, ndërsa sugjeroi që Komuna të hartojë një listë më kontakte nga Këshillat e fshatrave, shoqëria civile, studentë, grupe të ndryshme të qytetarëve, të cilët njoftohen edhe përmes emailit për takimet publike, konsultimet dhe dëgjimet buxhetore, pasi që shpesh herë njoftimi që bëhet përmes webfaqes dhe rrjetit social të komunës mund të mos shihet nga të gjithë. Gjithashtu, do të ishte mirë që të gjitha vendimet, rregulloret dhe aktet e tjera të publikohen edhe në gjuhët e tjera zyrtare në Kosovë.

Konsultimi publik me qytetarë përfundoi në ora 12:00 dhe pjesëmarrës ishin 24 qytetarë.

Procesmbajtës:

Bastri Duraku





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



Lista e pjesëmarrësve

Konsultimi publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Datë: 15.07.2025

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1	Rabije Xhafari	Rabije Xhafari
2	Samirje Iskollari	Samirje Iskollari
3	Nazime Memari	Nazime Memari
4	Hamid Makri	Hamid Makri
5	Besarta Iskollari	Besarta Iskollari
6	FAHRIJE HAXHA HUSEINI	Fahrije Haxha Huseini
7	Hyrie Uka Hoxha	Hyrie Uka Hoxha
8	Arbion Jusheci	Arbion Jusheci
9	Faruk Selimi	Faruk Selimi
10	Qesim Prustemi	Qesim Prustemi
11	Visar Sadriu	Visar Sadriu
12	ASTRIT IZMAKU	Astrit Izmaqu
13	YLLI IMERI	Ylli Imeri
15	Rajtim Krasnigj	Rajtim Krasnigj
16	Mentor Behrani	Mentor Behrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Konsultimi publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Datë: 15.07.2025

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
17	Levon Bojlloli	
18	Gëzim Saraci	
19	Armen Niftari	
20	Trifan Hoxani	
21	RINOR BEQIRI	
22	Blerina Nenin	
23	MIRIDON SADIKU	
24	BUJAR KLINAKU	
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues: Kryetari i Komunës

Hartues: Drejtoria për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

Tema: Propozim – Vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridik-OJQ dhe ndihme momentale personave fizike dhe bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më _____ 2025 merr këtë

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

1. Me këtë vendim ofrohet mbështetje financiare në shumën 4500 euro për z. _____ me nr.personal: _____ me vendbanim në Vushtrri, për shërim.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të sigurohen nga Drejtoria për Bujqsi, dhe Zhvillim Rural në kodin buxhetor 47024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave si dhe Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

Nr. / Br. 34823 / 25

Nr. i sq. / Br. st. -2-

Data: / Datum: 21.07.2025

VUSHTRRI - VUČITRN
Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr.122/25 21.07.2025

DATE/DATE/DATE:	21 korrik 2025
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	znj. Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për rishqyrtimin të vendimit

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Duke ju referuar shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit-vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë vendimi me numër të protokollit Nr.25196/25 i datës 03.06.2025 për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës - ri rregullim të kufirit të pronës në rr. “Ismail Parduzy” në Vushtrri sipas gjendjes faktike, e cila ka kërkuar që ky vendim të harmonizohet me legjislacionin duke respektuar nenin 43 pika 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

43.3 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Kryesuesja e kuvendit duke marrë dhe përmbushur këto obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju dërgon për rishqyrtim dhe harmonizim vendimin e cekur si më lartë.

Andaj bazuar në cekurat më lartë obligohet Kuvendi i Komunës së Vutshtrisë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë përcjellëse ju dërgojmë vendimin dhe gjitha shkresat e kësaj lënde.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrisë Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPI, Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPI-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPI-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPI.	Datë: 04.07.2025 VL-020-379
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Martin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e aktit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr. 25196/25 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduqi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.

I miratuar më datë: 03.06.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPI më datë: 13.06.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislationit në fuqi.

Arsyetim

MAPL konstaton se Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 03.06.2025 ka miratuar, Vendimin Nr. 25199/25 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

Në raportin e monitorimit është evidentuar se në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, të mbajtur me datë: 03.06.2025, lidhur me vendimin e lartshënuar një drejtor i ekzekutivit të Komunës, për rendin e ditës ka propozuar shtimin e 3 pikave shtesë për rendin e ditës gjatë zhvillimit të seancës, njëra prej tyre është edhe vendimi i cekur më lartë:

- Propozim-vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzi" në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

Rrejdhimisht propozimi i 3 pikave shtesë, aty për aty nga anëtari i ekzekutivit të Komunës së Vushtrisë, është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke marr për bazë edhe se anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk janë informuar me kohë për çështjet që janë objekt i trajtimit, nuk kanë poseduar materialet për pikat shtesë që do të diskutohen ashtu siç parashihet në nenin 43, pika 43.3, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale që përcakton:

"Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes", në njoftim përfshihen:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.

f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4, të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, duhet gjithashtu t'i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Poashtu është në kundërshtim me nenin 47 pika 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale që përcakton: se anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ (MAPI) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, neni 7, përkufizon se çka mund të konsiderohet urgjente, e ku bëjnë pjesë fatkeqësisht natyrore dhe çështje të natyrës së ngjashme.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë duhet që të ndërmerri veprime të rishqyrtojë aktin dhe harmonizoj sipas legjislationit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	25196/25
Nr. / Eq. / Br. st.	- 2 -
Data: / Datum:	09. 06. 25
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 93/25 05/06/2025

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), nenit 24, nenit 25 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 29, 30 dhe 31 të Rregullores (QRK)nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **03 qershor 2025**, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. “Ismail Parduži” në Vushtrri, sipas gjendjes faktike

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ariani Company SH.P.K me përfaqësues Naser Imeri.
